EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5694
E martë, 5 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

S'ka vendim për kompensimin e orëve të humbura të mësimit

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI FAQE 4-5

Taksa të pezullohet vetëm nëse kushtëzohet me reciprocitet

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se taksa ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjës mund të pezullohet vetëm nëse kushtëzohet me reciprocitet të plotë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse taksa do të pezullohej me këtë kushtëzim, edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës. Sipas tij, edhe amerikanët në masë të madhe i kanë kuptuar arsyet e vendosjes së taksës ndaj dhe kanë kërkuar pezullimin dhe jo largimin e saj

Kosova sërish aplikon për anëtarësim në Interpol

Republika e Kosovës edhe këtë vit ka aplikuar për t'u anëtarësuar në organizatën më të madhe të policisë ndërkombëtare, Interpol. Këtë e ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", Mentor Tahiri, këshilltar i lartë politik dhe shef i kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa. Ai ka treguar se kërkesa zyrtare për anëtarësim është bërë më 31 janar. Tahiri ka vlerësuar se Policia e Kosovës i plotëson të gjitha kriteret për t'u anëtarësuar në Interpol FAQE 3

'Bechtel Enka'-s i zgjatet për 152 ditë afati për përfundim të autostradës

FAQE 2

AKTUALE

PATRIOTËT E LESHIT DHE KURVAT POLITIKE TË KURVELESHIT! F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

KUSHTETUESJA HEDH POSHTË KËRKESËN E ABRASHIT PËR PËRSËRITJEN E ZGJEDHJEVE NË PRISHTINË F. 7

ODA E INFERMIERËVE, E PAKËNAQUR ME LIGJIN PËR PAGAT F. 6

EKONOMI

ÇFARË DO TË THOTË RRITJA E PAGAVE NË KOSOVË, NGA NJË KËND TJETËR? F. 8

Burim PIRAJ

MINISTRI HAMZA MERR MBËSHTETJE NGA BORDI I DREJTORËVE TË BERZH-it F. 6

KULTURË

PËR KË BIE KAMBANA? F. 8

Agim VINCA

SPORT

REXHA: DUHET TA ELIMINOJMË FERIZAJN, SYNOJMË KUPËN F. 15

MË 9 SHKURT FILLON STINORI PRANVEROR NË HENDBOLL F. 15

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Majlinda Bregu takon presidentin serb Vuçiq

BEOGRAD, 4 SHKURT - Drejtuesja e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Majlinda Bregu, ka mbyllur të hënën turin në Serbi me presidentin Aleksandër Vuçiq. "Një takim shumë konstruktiv me presidentin Vuçiq. Është në interesin e përbashkët për të ecur përpara si rajon dhe të flasim haptazi me njëri-tjetrin", shkruan Bregu në "Twitter" teksa shprehet për integrimin e Ballkanit Perëndimor.

Kujtojmë se një ditë më parë Bregu pati takime me ministrat e rinj të qeverisë Rama, ndër to ministrin Gent Cakaj, të Infrastrukturës dhe Energjetikës, Belinda Ballukun, të Arsimit, Besa Shahinin dhe të Financave, Anila Denaj. "Takimet shqip në Tiranë gjatë fundjavës. 2019 nuk është vetëm viti i sfidave por, mbi të gjitha, i rezultateve të prekshme për qytetarët në Ballkanin Perëndimor", shkruante Bregu në "Instagram".

Bregu e nisi turin ballkanik në Maqedoni, për të vijuar në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Të gjitha takimet kanë qenë të nivelit të lartë në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

'Bechtel Enka'-s i zgjatet afati për përfundim të autostradës 'Arben Xhaferi'

Anekskontrata e nënshkruar nga palët përcakton detyrimet e Qeverisë së Kosovës për 53 milionë euro për Autostradën Prishtinë - Hani i Elezit (Autostrada "Arben Xhaferi"). Me këtë anekskontratë, përveç 53 milionëshit, MI-ja është pajtuar që të zgjatet afati i implementimit të kontratës bazë deri më 1 qershor 2019, përkatësisht 152 ditë i jepen kohë shtesë "Bechtel Enka"-s për zbatimin e punëve për këtë autostradë



PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës/Transparency International Kosova ka gjetur se Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe "Bechtel Enka" janë marrë vesh që kësaj të fundit t'i zgjatet afati për 152 ditë për t'i përfunduar punimet në autostradën Prishtinë - Hani i Elezit, gjë që ia pamundëson Qeverisë së Kosovës të kërkojë penallti për moszbatim të kësaj kontrate me kohë. Kjo është paraparë në anekskontratën e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe "Bechtel Enka", kopje e cila mban datën 5 shtator 2018, të cilën e ka siguruar KDI-ja.

Anekskontrata e protokolluar me numër 02/8457 dhe e nënshkruar nga palët përcakton detyrimet e Qeverisë së Kosovës për 53 milionë euro për Autostradën Prishtinë - Hani i Elezit (Autostrada "Arben Xhaferi"). "Me këtë aneks kontratë, përveç 53 milionëshit, MI-ja është pajtuar që të zgjatet afati i implementimit të kontratës bazë deri më 1 qershor 2019, përkatësisht 152 ditë i jepen kohë shtesë 'Bechtel Enka'-s për zbatimin e punëve për këtë autostradë. Në anën tjetër ministria vazhdimisht, përmes prononcimeve në media të ministrit Pal Lekaj, ka deklaruar se janë duke shikuar mundësitë për vënien e penalltive për vonesa të 'Bechtel Enka'-s për kryerjen e punëve", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Sipas kësaj anekskontrate, nuk është e qartë se si janë kalkuluar 53 milionë euro dhe se në çfarë baze është shtyrë afati për plus 152 ditë shtesë. KDI-ja në konferencë për media, në dhjetorin e 2018-s, ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës sqarime se si janë kalkuluar 53 milionë euro, por deri më tani nuk kemi pranuar asnjë informatë shtesë.

Ndërkaq MI-ja në reagimin e saj bën me dije se "kontrata për realizimin e Projektit të autostradës 'Arbën Xhaferi' ka qenë e planifikuar të përfundonte në janar të vitit 2018". Duke parë se një gjë e tillë është e pamundur, për shkaqe të njohura tani për publikun, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më 27 shtator 2017, kishte zgjatur kohën për përfundimin e këtij projekti deri më 31. 12. 2018, ndërsa shpenzimet për këtë zgjatje do të përcaktoheshin më vonë", thuhet në njoftim. "Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 5 qershor 2018, për akordimin e shumës prej 53,1 milionë eurosh në emër të kontratës së datës 27 shtator 2017, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më 5 shtator 2018 ka nënshkruar një aneks të kontratës për përcaktimin e afateve kohore të pagesës së kësaj shume, e cila pritet të paguhet në këste të barabarta deri më 1 qershor 2019", thuhet më tej në sqarimin për media të kësaj ministrie. Prandaj, sipas Ministrisë që drejtohet nga Pal Lekaj, nuk është i saktë konstatimi se MIT ka zgjatur kohën për përfundimin e punëve ndërtimore në projektin e autostradës "Arbën Xhaferi", por vetëm afatin për pagesën e shumës së shpenzimeve për zgjatjen e kësaj kontrate.

Ministri Lleshaj, takime zyrtare në Turqi

TIRANË, 4 SHKURT - Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Sandër Lleshaj, po zhvillon një vizitë zyrtare në Turqi, me ftesë të ministrit të Brendshëm turk Süleyman Soylu. Gjatë takimit në Ministrinë e Brendshme, ministri Soylu vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve, i cili, sipas tij, mbështetet në faktorë historikë si dhe në praninë e madhe të faktorit shqiptar në Turqi. Më tej, Soylu e vuri theksin në krijimin e një klime më të ngushtë komunikimi mes dy vendeve në fusha të interesit të përbashkët si ajo e sigurisë, migracionit të paligjshëm dhe luftës kundër terrorizmit, për të cilat kërkoi thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve.

Ministri Lleshaj në fjalën e tij ndau qëndrime të njëjta me homologun turk lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit si dhe shprehu angazhimin për një intensifikim të përpjekjeve për të adresuar së bashku çështje të rendit, sigurisë, migracionit të paligjshëm, luftës kundër narkotikëve dhe terrorizmit.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kosova sërish aplikon për anëtarësim në Interpol

Republika e Kosovës edhe këtë vit ka aplikuar për t'u anëtarësuar në organizatën më të madhe të policisë ndërkombëtare, Interpol. Këtë e ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", Mentor Tahiri, këshilltar i lartë politik dhe shef i kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa. Ai ka treguar se kërkesa zyrtare për anëtarësim është bërë më 31 janar. Tahiri ka vlerësuar se Policia e Kosovës i plotëson të gjitha kriteret për t'u anëtarësuar në Interpol

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Shteti i Kosovës më 31 janar ka bërë kërkesë zyrtare për anëtarësim në Interpol. Lajmin e ka konfirmuar të hënën për gazetën "Epoka e re", Mentor Tahiri, shef i kabinetit dhe këshilltar i lartë politik i ministrit të Punëve të Brendshme Ekrem Mustafa. Ai ka vlerësuar se Policia e Kosovës i plotëson të gjitha kriteret për t'u anëtarësuar në Interpol. Tahiri ka thënë se policia vazhdon të jetë ofruese e sigurisë ndërkombëtare, por anëtarësimi në këtë organizatë do të formalizojë këtë bashkëpunim dhe do të vë Policinë e Kosovës në pozicion plotësisht të barabartë në rrafsh ndërkombëtar. Por, sipas tij, sa i përket këtij procesi sfidues, mbetet konotacioni aktual gjeopolitik në botë dhe qëndrimi i paarsyeshëm i disa shteteve me orientim antiperëndimor. "Mund të konfirmoj se Republika e Kosovës më 31 janar ka aplikuar zyrtarisht për anëtarësim në Interpol. Lidhur me këtë janë ndjekur të gjitha procedurat dhe afatet kohore që aplikimi për Interpol të shqyrtohet brenda këtij viti. Bazuar në raportin e progresit të lëshuar nga BE-ja si dhe nga vlerësimet e tjera të pavarura, Policia e Kosovës plotëson të gjitha kriteret për t'u anëtarësuar në Interpol. Policia e Kosovës edhe deri më tani ka gjetur mundësitë e bashkëpunimit me Interpol dhe vazhdon të jetë ofruese e sigurisë ndërkombëtare. Anëtarësimi tani do të formalizojë këtë bashkëpunim dhe do të vë Policinë e Kosovës në pozicion plotësisht të barabartë në rrafsh ndërkombëtar. Sfiduese mbetet konotacioni aktual gjeopolitik në botë dhe qëndrimi i paarsyeshëm i disa shteteve me orientim antiperëndimor", është shprehur Tahiri.

Ai ka thënë se çdo anëtarësim i Republikës së Kosovës në kuadër të mekanizmave të sistemit ndërkombëtar, jo vetëm politik, por edhe të sigurisë, është një hap drejt forcimit të shtetësisë. Në këtë kontekst, Tahiri ka theksuar se deri më tani Serbia ka aktivizuar të gjitha resurset e saj që ta pengojë anëtarësimin në Interpol dhe këtë ia ka arritur për faktin se për anëtarësim në Interpol ka kriter tjetër të shumicës dhe jo kriter të shumicës absolute. Megjithatë, ai ka thënë se anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Interpol nuk duhet të shihet nga prizmi politik. Sipas Tahirit, me anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë do të përfitojnë të gjithë aktorët ndërkombëtarë të sigurisë, përfshirë edhe ata rajonalë. "S'ka dyshim se çdo anëtarësim i Republikës së Kosovës në kuadër të mekanizmave të sistemit ndërkombëtar, jo vetëm politik, por edhe të sigurisë, shihet si një hap tutje drejt forcimit të shtetësisë. Deri më tani Serbia ka aktivizuar të gjitha resurset e saj që ta pengojë anëtarësimin. Në Interpol këtë ia ka arritur për faktin se për anëtarësim në Interpol ka kriter tjetër të shumicës dhe jo kriter të shumicës absolute. Gjithsesi, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Interpol nuk duhet të shihet nga prizmi politik. Mbi të gjitha, kemi të bëjmë me sigurinë, e në këtë drejtim me anëtarësimin e vendit tonë, përfitojnë të gjithë aktorët ndërkombëtarë të sigurisë, përfshirë edhe ata rajonalë", ka deklaruar Tahiri.

Aplikimi për anëtarësim në Interpol është përkrahur nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj. Ai ka thënë se Policia e Kosovës i plotëson të gjitha kushtet për t'u bërë pjesë e organizatës më të madhe të policisë ndërkombëtare. Sipas Qalajt, ky anëtarësim i Kosovës është në interes të vet Interpolit. "Policia e Kosovës nuk është anëtare e Interpolit jo për shkak të profesionalizimit, por për arsye gjeopolitike dhe të lobimit të Serbisë e aleatëve të saj. Sa më shpejt që është e mundur duhet të jemi pjesë e Interpolit. Nuk është vetëm interes i Policisë së Kosovës, por interes i vet Interpolit", ka deklaruar Qalaj në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re".

Edhe ish-drejtori i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive, Kosova edhe këtë vit duhet t'i vazhdojë përpjekjet për t'u bërë pjesë e Interpolit. "Asnjëherë Kosova nuk duhet të heqë dorë nga nevoja e të qenit anëtare e Interpolit. Në këtë aspekt duhet të bëhen punë, përkushtim dhe angazhim. Unë i përgëzoj kolegët e mi për punën e mirë që po bëjnë, por dështimi në Interpol nuk duhet t'i demotivojë ata. Përkundrazi, duhet t'i fuqizojë që të jenë të vendosur në punën e tyre sepse Kosovës nuk ia duan të mirën ata që duan ta shohin vendin tonë të zhytur në krim. Prandaj, jam i bindur se Policia e Kosovës do të angazhohet edhe më fuqishëm për luftimin e krimit", ka thënë Ahmeti për gazetën "Epoka e re".

58.8 milionë euro të hyra për muajin janar

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se suksesshëm ka nisur edhe vitin 2019, referuar mbledhjes së të hyrave për muajin janar. Sipas një njoftimi të ATK-së, për këtë periudhë janë mbledhur 58.8 milionë euro, ku në krahasim me planin, janë mbledhur 662.138 euro me shumë apo 101.14 për qind. Ndërsa, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, janë mbledhur 7.4milionë euro më shumë. "ATK-ja do të vazhdojë ta realizojë misionin e vet në mënyrë që të krijohet stabilitet financiar në vend", është thënë në njoftimin për media.

Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

Taksa të pezullohet vetëm nës

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se taksa ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjës mund të pezullohet vetëm nëse kushtëzohet me reciprocitet të plotë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse taksa do të pezullohej me këtë kushtëzim, edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës. Sipas tij, edhe amerikanët kanë kuptuar në masë të madhe arsyet e vendosjes së taksës, ndaj kanë kërkuar pezullimin dhe jo largimin e saj

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, e ka përkrahur taksën prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Ai ka bërë me dije se kjo taksë mund të pezullohet vetëm nëse kushtëzohet me reciprocitet të plotë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka deklaruar se nëse taksa do të pezullohej me këtë kushtëzim, edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës. "Taksa mund të pezullohet për një kohë të caktuar vetëm nëse zëvendësohet me reciprocitet të plotë në marrëdhëniet tregtare dhe jo vetëm midis dy shteteve. Mendoj se në këtë drejtim janë edhe dhjetë kërkesat e liderit të PDK-së dhe të kreut të Kuvendit, z. Veseli", ka thënë Gashi. Ai ka vlerësuar se tani edhe bashkësia ndërkombëtare i ka kuptuar arsyet e vendosjes së taksës. Sipas Gashit, pezullimi i taksës me këtë kushtëzim nuk do të ndikonte në raportet e Kosovës me ShBA-në. "Pala amerikane i ka kuptuar në masë të madhe arsyet e vendosjes së taksës, ndaj ka kërkuar pezullimin dhe jo heqjen e saj. Mendoj se, duke e pezulluar përkohësisht taksën, me kushtin që e cekëm më lart, do t'i ruanim raportet e mira me ShBA-në, diçka që është e rëndësisë primare për Kosovën", është shprehur ai.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare ka folur edhe për kushtet e qeverisë për ta hequr taksën. Gashi ka thënë se është vështirë e besueshme që Serbia heqjen e taksës do ta këmbejë me njohjen e Kosovës. "Të gjitha kushtet e qeverisë janë të drejta në parim, por është vështirë e besueshme që Serbia heqjen e taksës do ta këmbente me njohjen e Kosovës. Ndoshta hapi i parë drejt njohjes është kushtëzimi i pezullimit të taksës me zbatimin e reciprocitetit të plotë midis dy shteteve, si fazë testuese për Serbinë, para se t'i kërkohet njohja. Mendoj se nëse taksa do të pezullohej përkohësisht me këtë kushtëzim edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës", ka thënë Gashi.

"Epoka e re": *Z. Gashi, Kosova gjendet në një presion të vazhdueshëm nga ShBA-ja për ta pezulluar taksën për produktet e Serbisë dhe të Bosnjës. Si duhet t'i përgjigjet Kosova kësaj kërkese të ShBA-së?*

Gashi: Taksa mund të pezullohet për një kohë të caktuar vetëm nëse zëvendësohet me reciprocitet të plotë në marrëdhëniet tregtare dhe jo vetëm midis dy shteteve. Mendoj se në këtë drejtim janë edhe dhjetë kërkesat e liderit të PDK-së dhe kreut të Kuvendit, z. Kadri Veseli.

"Epoka e re": *Qeveria e Kosovës heqjen e taksës e ka kushtëzuar me disa kushte, në mesin e tyre edhe njohjen nga Serbia. Si i keni parë këto kushte të Qeverisë?*

Gashi: Të gjitha kushtet e Qeverisë janë të drejta në parim, por është vështirë e besueshme që Serbia heqjen e taksës do ta këmbente me njohjen e Kosovës. Ndoshta hapi i parë drejt njohjes është kushtëzimi i pezullimit të taksës me zbatimin e reciprocitetit të plotë midis dy shteteve si fazë testuese për Serbinë para se t'i kërkohet njohja. Nëse taksa do të pezullohej përkohësisht me këtë kushtëzim edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës.

"Epoka e re": *Nëse qeveria vazhdon ta refuzojë heqjen e taksës, a mund të ketë kjo*

e kushtëzohet me reciprocitet

ndikim në raportet e Kosovës me ShBA-në?

Gashi: Pala amerikane i ka kuptuar në masë të madhe arsyet e vendosjes së taksës, ndaj e ka kërkuar pezullimin dhe jo heqjen e saj. Duke e pezulluar përkohësisht taksën, me kushtin që e cekëm më lart, do t'i ruanim raportet e mira me ShBA-në, diçka që është e rëndësisë primare për Kosovën.

"Epoka e re": *Kuvendi i Kosovës tashmë ka miratuar edhe Ligjin për dialogun me Serbinë. Sa sfiduese do të jetë kjo fazë e dialogut për Kosovën?*

Gashi: Uroj të jemi në fazën finale të dialogut dhe të kemi për epilog një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Duke parë kushtëzimet e njëpasnjëshme të Serbisë për vazhdimin e dialogut, të krijohet përshtypja se Serbia i nxjerr këto kushte vetëm për ta prolonguar vazhdimin e dialogut dhe për të mos arritur shpejt të një marrëveshje përfundimtare.

"Epoka e re": *Qendrat e mëdha ndërkombëtare kanë bërë me dije se viti 2019 është momentumi më i mirë për marrëveshjen historike në mes të dy shteteve. Si historian dhe njohës i historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare, cili mund të jetë epilogu i këtij procesi?*

Gashi: Nuk mund të them se a është ky momentumi më i mirë, por një gjë është e sigurt, se Kosova deri në arritjen e kësaj marrëveshje po shënon ngecje për afirmimin e shtetësisë së saj në planin ndërkombëtar. Procesi i njohjeve ka ngecur, madje ka propagandë retrograde të zhvilluar nga Serbia dhe miqtë e saj për tërheqjen e njohjeve. Është vështirë të prognozohet epilogu i kësaj marrëveshje, por pala e Kosovës ka argumente nga e drejta ndërkombëtare (vendimi i GjND-së i vitit 2010) dhe obligime kushtetuese për të ruajtur dhe afirmuar sovranitetin politik dhe territorial të shtetit të Kosovës në kufijtë ekzistues.

S'ka vendim për kompensimin e orëve të humbura të mësimit

Prishtinë, 4 shkurt - Pas tri javëve të grevës, nga e hëna në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë ka rifilluar procesi mësimor. Pas arritjes së qëllimit për rritjen e koeficientit të pagave për mësimdhënësit, tani çështje tjetër që pret zgjidhje është se si do të kompensohen orët e mësimit të humbura përgjatë tri javëve të grevës.

Janë gjithsej 14 ditë mësimi të humbura, për të cilat Këshilli i Prindërve të Kosovës kërkon që kompensimi të realizohet në momentet më të favorshme për nxënësit.

Kryetari i këtij Këshilli, Ymret Reshitaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se prindërit kërkojnë nga institucionet arsimore ta vendosin kohën për kompensimin e njësive mësimore. Sipas tij, Këshilli ende nuk ka propozuar ndonjë periudhë ose ditë konkrete, por bëhet fjalë për vijimin e mësimit edhe të shtunave, pastaj gjatë festave, si dhe anulimin e pushimit pranveror, i cili, sipas kalendarit shkollor, është në muajin prill. Një opsion tjetër është edhe zgjatja e procesit mësimor në kohën e pushimeve verore. "Tri javë është një humbje shumë e madhe. Megjithatë, unë konsideroj se Ministria e Arsimit, së bashku me ekspertët, duhet të bëjë një plan specifik, sepse kjo situatë që ka ndodhur me kohëzgjatje të madhe të grevës, me të vërtetë do të sjellë shumë probleme lidhur me zëvendësimin e orëve mësimore", ka thënë Reshitaj.

Sipas përfaqësuesve të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK), sindikatë kjo që ka organizuar grevën, në bazë të Ligjit për greva nuk është e obliguar që orët e humbura të kompensohen. Por, megjithatë, Vjollca Shala, nënkryetare e SBAShK-ut, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se mësimdhënësit do t'i zëvendësojnë orët e humbura. Ajo ka theksuar se u mbetet mësimdhënëse që të vendosnin se në çfarë kohë do të kompensohen orët e humbura. "Mësimdhënësit do t'i kompensojnë patjetër njësitë mësimore dhe do të arrijnë rezultatet e duhura. SBAShK-u tashmë ka angazhuar kryetarët e shoqatave që të bisedojnë me mësimdhënësit dhe çfarëdo që vendosin ata, ne do të jemi zëri i tyre dhe do të vendosim. Po ashtu, do të konsultohemi edhe me drejtoritë komunale të arsimit, mirëpo mësimdhënësit vendosin", ka thënë Shala.

Ndërkaq, sipas Udhëzimit Administrativ për kalendarin e vitit shkollor 2018/2019, thuhet se për çdo ndryshim të kalendarit, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) merr vendim të veçantë. Kurse në Ligjin për arsimin parauniversitar në Kosovë thuhet se "Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore lidhur me: kalendarin shkollor dhe periudhën kohore të vitit shkollor në kuadër të Kornizës së Kurrikulës të Kosovës dhe kohëzgjatjen e orës së mësimit dhe pushimeve shkollore ose festat".

Valmir Gashi, këshilltar politik i ministrit të Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Ministria do t'i ftojë drejtorët e drejtorive komunale të arsimit dhe në koordinim me ta do të vendoset se cilat janë ditët apo koha më e përshtatshme për t'i zëvendësuar orët e humbura.

Pas tre javësh grevë, sindikalistët e arsimit janë pajtuar me ofertën e institucioneve për rritjen e koeficientit të pagave, në Ligjin për Paga, por jo në nivelin që është kërkuar nga SBAShK-u. Ndërkaq Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), përmes një komunikate për media, ka thënë se "kush do të japë përgjegjësi për këtë mashtrim dhe dëm që u është bërë nxënësve të të gjitha niveleve për shkak të grevës së panevojshme dhe të paarsyeshme? A duhet nxënësit ta humbin pushimin duke mbajtur orë plotësuese e zëvendësuese për shkak të papërgjegjësisë së SBAShK-ut?" KMDLNj-ja mendon se orët nuk duhet të zëvendësohen, por se duhet të thirren në përgjegjësi të gjithë ata që kontribuuan për këtë gjendje, "që nga institucionet parashkollore e deri tek ai i arsimit të lartë", thuhet në komunikatën për media të KMDLNj-së.

Tërnava merr pjesë në konferencën e Abu Dabit

Prishtinë, 4 shkurt (ER) - Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, nga e shtuna ndodhet në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, ku po merr pjesë në Konferencën Globale të Vëllazërisë Njerëzore, në të cilën janë të pranishëm rreth 1 500 përfaqësues të feve të ndryshme nga e gjithë bota, ndër të cilët duhet veçuar praninë e dy prijësve të shquar fetarë, Shejhul Al-Az-harit, Shejh Ahmed al-Tajjib dhe Papa Françeskut - kreu i Kishës Katolike.

Ndër temat kryesore të kësaj konference përmendim vlerat humane, modelin e përbashkët të tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfetare, si dhe besimin në një të ardhme të përbashkët njerëzore.

Në këtë konferencë ndërkombëtare, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, para të pranishmëve, në sesionin e dytë referoi për kultivimin e harmonisë e mirëkuptimin ndërfetar te shqiptarët ku, ndër të tjera, theksoi se shembulli i harmonisë dhe tolerancës te shqiptarët në përgjithësi dhe në veçanti në Kosovë është vlerë dhe model që duhet ta ndjekin edhe popujt e tjerë.

Gjatë zhvillimit të punimeve të konferencës, myftiu Tërnava ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të besimeve të tjera nga vende të ndryshme të botës me të cilët ka ndarë modelin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare të vendit tonë.

Oda e Infermierëve, e pakënaqur me Ligjin për pagat

Prishtinë, 4 shkurt (ER) - Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës ka shprehur zhgënjimin e thellë pas aprovimit të Ligjit të pagave nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Arsye për këtë është trajtimi jo i barabartë dhe diskriminues i profileve që përfaqëson OIK-u me profesionistët e tjerë të së njëjtës kategori sipas shkollimit (bachelor tre vjet). "Ne si OIK do t'i përdorim të gjithë mekanizmat institucionalë dhe ligjorë që deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji të shikohet mundësia nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë çështje që të bëhet përmirësimi i këtij ligji dhe zgjidhja e kësaj padrejtësie për komunitetin që përfaqëson OIK", është thënë në reagimin e Odës së Infermierëve të Kosovës.

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës ka theksuar se, bazuar në kompetencat që ka, do t'u drejtohet me shkresë të veçantë ministrit të Shëndetësisë, ministrit të Administratës Publike, kryeministrit, kryeparlamentarit, komisioneve parlamentare të përfshira në hartimin e këtij ligji, presidentit e, po ashtu, edhe Gjykatës Kushtetuese, për mbrojtje legjitime të interesave të këtij komuniteti, duke u mbështetur në nivelet e shkollimit krahasuar me nivelet e tjera të ngjashme të shkollimit bachelor tre vjet të përfshira në këtë ligj.

Veseli uron nisjen e procesit mësimor, kërkon ngritje të cilësisë në arsim

Nga shkolla "Jeronim De Rada" në Ferizaj, kryeparlamentari Veseli uroi të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e Kosovës për nisjen e gjysmëvjetorit të dytë, ndërsa u bëri thirrje të punojnë më shumë për rritjen e cilësisë.

Ferizaj, 4 shkurt (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu dhe nga deputeti i këtij qyteti, Ilmi Reçica, kanë vizituar të hënën Shkollën Fillore "Jeronim De Rada" në ditën e parë të gjysmëvjetorit të dytë.

Kreu i Kuvendit u mirëprit nga drejtoresha e shkollës, Servete Hajrullahu, nga mësimdhënësit dhe nga nxënësit, të cilët i uroi për rikthimin në procesin mësimor.

Nga shkolla "Jeronim De Rada" në Ferizaj, kryeparlamentari Veseli uroi të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e Kosovës për nisjen e gjysmëvjetorit të dytë, ndërsa u bëri thirrje të punojnë më shumë për rritjen e cilësisë. "Me ligjin e ri të pagave, të gjithë punëtorët e sektorit publik në Kosovë, duke filluar nga mësimdhënësit, personeli shëndetësor, ushtarët, policët dhe të gjitha kategoritë e tjera, kanë pagat më të larta jo vetëm në regjion, por i kalojnë edhe disa vende të Bashkimit Evropian. Tani ne kërkojmë më shumë përkushtim në punë, në mënyrë që ta rrisim cilësinë në arsim dhe nxënësit tanë ta marrin dijen e nevojshme për t'u përgatitur për konkurrencën globale që na pret në treg", ka thënë Veseli.

Sylejman Selimi viziton Isa Mustafën

Prishtinë, 4 shkurt (ER) - Ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi, i cili është liruar para pak ditësh nga burgu, ka vizituar të hënën kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa. Lajmin e ka bërë me dije Mustafa përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". "Sot ishte nder i veçantë për mua dhe familjen time, të më vizitojë ish-komandanti i UÇK-së, gjeneral Sylejman Selimi, i shoqëruar nga deputeti dhe bashkëluftëtari Anton Quni, i cili u interesua për shëndetin tim. Gjeneral Selimit i shpreha gëzimin tim për lirimin e tij, por edhe admirimin për qëndresën e tij burrërore e patriotike gjatë gjithë kësaj periudhe. Si komandant i UÇK-së dhe më vonë në pozita të rëndësishme të larta shtetërore, gjeneral Selimi dha kontribut të rëndësishëm për çlirimin dhe shtetndërtimn e Kosovës", ka shkruar Mustafa.

Kushtetuesja hedh poshtë kërkesën e Abrashit për përsëritjen e zgjedhjeve në Prishtinë

Prishtinë, 4 gusht (ER) - Arban Abrashi, ish-kandidat i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në garën për kryetar të Komunës së Prishtinës në zgjedhjet e fundit lokale, e ka humbur rastin e dërguar në Gjykatën Kushtetuese përmes të cilit ka pretenduar të vë në pikëpyetje postin e kryetarit aktual, Shpend Ahmeti.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shkon në favor të mbetjes edhe më tej të Shpend Ahmetit në postin e kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe i pamundëson zgjedhjet e parakohshme në Prishtinë.

Abrashi ka pretenduar se Gjykata Supreme, por edhe Paneli për Ankesa dhe Parashtresa, në procedurat e zhvilluara për shqyrtimin e ankesave dhe apeleve të tij, kanë dështuar të ofrojnë mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Pretendimet e Abrashit, se është dëmtuar në procesin zgjedhor, janë vlerësuar të pabaza nga Gjykata Kushtetuese.

Gara zgjedhore për Prishtinën, në vitin 2017, ndërmjet Ahmetit dhe Abrashit, ka qenë mjaft e ngushtë. Ahmeti e ka fituar postin e të parit të Prishtinës me rreth 200 vota më shumë.

Veseli thotë se taksa për produktet serbe do të mbetet

Prishtinë, 4 shkurt - "Tarifa doganore mbi mallrat e Serbisë është vendosur për të mirën e Kosovës dhe ajo nuk bën të kthehet kundër të mirës së Kosovës", kështu ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. "E kemi vendosur tarifën 100 për qind mbi produktet dhe mallrat serbe për shkak se Serbia na e ka imponuar një masë të tillë dhe tarifa do të qëndrojë", ka thënë Veseli. Ai i ka bërë këto komente gjatë vizitës në një shkollë fillore në Ferizaj. Megjithatë, Veseli, duke aluduar në propozimin e tij për një pezullim të vendimit të Qeverisë së Kosovës për taksën doganore për 120 ditë, ka thënë se propozimi është konkret bazuar në kërkesën e Shteteve të Bashkuara.

Por, sipas tij, kjo do të ishte vetëm masë e përkohshme, ndërkohë që institucionet e Kosovës do t'i nisnin veprimet që të mos lejojnë më hyrjen e mallrave në Kosovë me mbishkrimin "Kosovë e Metohi" si dhe pa i respektuar institucionet e Kosovës.

Veseli ka thënë se në këtë drejtim është duke u punuar intensivisht dhe se "Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk bën të kenë qëndrime të ndryshme përballë Serbisë".

Qeveria e Kosovës më 21 nëntor të vitit të kaluar ka vendosur taksën doganore prej 100 % mbi prodhimet e importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Autoritetet e Serbisë kanë thënë se nuk do ta vazhdojnë dialogun me Kosovën në rast se taksa për produktet e Serbisë nuk hiqet nga Qeveria e Kosovës.

Mustafa dërgon në MPJ kërkesat për njohje reciproke të patentëshoferëve me shtetet e BE-së

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme kërkesat për marrje të rekomandimit për miratim në parim me shtetet e BE-së për njohje reciproke të patentëshoferëve

EPOKA E RE — Faton DËRMAKU

Prishtinë, 4 shkurt - Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të përpjekjeve për njohje ndërkombëtare të dokumenteve personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, deri në tani ka nënshkruar marrëveshje me Republikën e Shqipërisë dhe të Maqedonisë për njohje reciproke të patentëshoferëve të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të përpjekjeve për shtrirje më të madhe të njohjeve të patentëshoferëve, ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka nënshkruar dhe dërguar në ministrinë e Punëve të Jashtme kërkesat për marrje të rekomandimit për miratimin në parim nga qeveria të nismave për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për njohjen reciproke të patentëshoferëve. Me këtë rast, kërkohet që ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale Gjermane, Konfederatës Helvetike, Republikës Franceze dhe Republikës së Malit të Zi, të fillojnë nisma për njohje reciproke të patentëshoferëve.

Ministria e Punëve të Brendshme vitin e kaluar ka lansuar patentëshoferin me dizajn të ri, i cili është i pajisur me teknologjinë e fundit për siguri të dokumenteve dhe është në harmoni me direktivat e BE-së.

Çfarë do të thotë rritja e pagave në Kosovë, nga një kënd tjetër?

Burim PIRAJ

Është predikuar kohë të gjatë se rritja e pagave është e rrezikshme dhe se nuk bën të kalojë 40 për qind të buxhetit të shtetit e të tjera gjëra. Në realitet, rritja e pagave dhe mëditjeve si dhe rritja e buxhetit për kulturë rini dhe sport, si dhe për aktivitete të tjera, ku paratë derdhen direkt në popull, në Kosovë kanë efekt shumë pozitiv.

Arsyeja e kësaj është se në këtë mënyrë paraja shkon në duar të popullatës dhe ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit! Krejt meseleja është që para për investime kapitale do të ketë më pak, ose për ta shpjeguar më mirë, kjo qeveri mundësinë e pasurimit nga tenderët e ka më të vogël!

Ku është thelbi?

Është se me paga ndahet paraja në tërë territorin e Kosovës, ndërsa me tenderë përfitojnë vetëm individët apo klanet e caktuara dhe ata pasurohen në mënyrë marramendëse. Prandaj, i gëzohem rritjes së pagave dhe shpresoj të rriten edhe më shumë. Sektori privat nuk do ta ketë pengesë rritjen e pagave, por do të ketë mundësi për zhvillim edhe më të madh. Kështu që, duhet strategji dhe të mos frikësohen që edhe në sektorin privat të rriten pagat ngaqë punë do të ketë më shumë dhe do të ngrihet përgjegjësia e punëtorëve shumë më shumë dhe me ngritjen e përgjegjësisë, normalisht se rezultatet nuk do të mungojnë.

Rukiqi: Ligji për pagat krijon hendek në mes të sektorit publik dhe privat

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se Ligji për pagat krijon një dallim të madh në mes të sektorit publik dhe atij privat. Ai ka thënë se për sektorin privat është shqetësues Ligji i pagave pasi, sipas tij, një shumë e madhe e buxhetit shkon për paga dhe skema sociale.

Rukiqi ka thënë se sektori privat ende mbetet me pagën mesatare tejet të ulët. "Për sektorin privat është shqetësuese si kemi ardhur te një politikë që 1.4 miliard e buxhetit i lë për paga dhe skema sociale. Në asnjë rast shpenzimi i tillë i buxhetit nuk është as stimulues dhe as fuqizues i rritjes ekonomike të qëndrueshme. Mund ta arrijë konsumin për një fazë të qëndrueshme, por është rritje e njëhershme dhe krijon diskrepancë të madhe në mes të sektorit privat dhe publik", ka deklaruar Rukiqi në një konferencë për medie.

Ai ka thënë se nuk mund të ketë rritje ekonomike të qëndrueshme në bazë të kësaj politike që po bëhet. "Burim i rritjes ekonomike është konsumi dhe investimet publike. Konsumi nga diaspora dhe investimet shkojnë në infrastrukturën rrugore", u shpreh ai. Rukiqi, po ashtu, ka folur edhe për ndikimin e taksës 100 për qind, ku tha se ka ndikuar në rritjen e prodhimit vendor dhe, sipas tij, është rritur gatishmëria e prodhuesve për të investuar. Ai ka ftuar bizneset ta shfrytëzojnë mekanizmin për mbrojtjen e interesave të tyre përmes zyrës e cila ndodhet në Kuvendin e Kosovës. "Qëllimi i kësaj zyre është ta fuqizojë dhe prezantojë biznesin në procesin legjislativ, duke qenë se ka shumë ligje që kalojnë pa asnjë filtër dhe pastaj dëmin e paguajnë tatimpaguesit më të mëdhenj, bizneset", është shprehur Rukiqi.

MBPZhR-ja mbyll sezonin e gjuetisë për periudhën 2018-2019

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë vendim për mbylljen e sezonit të gjuetisë për periudhën 2018-2019. Sezoni i gjuetisë për të gjitha llojet e kafshëve të egra në tërë territorin e Republikës së Kosovës do të mbyllet më 8 shkurt të këtij viti.

Mbyllja e sezonit të gjuetisë është bërë me kërkesën e Departamentit të Pylltarisë në MBPZhR, i cili ka vlerësuar se ka zvogëlim të kafshëve të egra si pasojë e gjuetisë ilegale, degradimit të habitateve natyrore, e sidomos pyjeve, kushteve të pavolitshme klimatike dhe për shkak të menaxhimit joefikas të faunës së egër. Këtë vendim obligohet që ta zbatojnë Agjencia Pyjore e Kosovës, Federata e Gjahtarëve të Kosovës, menaxherët e vendgjuetive, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe drejtoritë komunale për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.

Ministri Hamza merr mbështetje nga bordi i drejtorëve të BERZh-it

Ministri i Financave, Bedri Hamza, është takuar me delegacionin e bordit të drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Drejtorët e bordit të BERZh-it kanë konfirmuar gatishmërinë e këtij institucioni ndërkombëtar që ta vazhdojë përkrahjen e ekonomisë së Kosovës dhe të punës së qeverisë për përmirësimin e jetës së qytetarëve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të hënën në takim delegacionin e bordit të drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), i udhëhequr nga drejtori i Konstituencës së Holandës, Kinës, Mongolisë, Maqedonisë dhe Armenisë, Frans Weekers, dhe drejtori i bordit për Irlandën, Danimarkën, Lituaninë dhe Kosovën, Patrick Walsh.

Anëtarët e bordit të drejtorëve të BERZh-it, të cilët kanë marrë pjesë në këtë takim, kanë përfaqësuar 32 vende të botës. Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe BERZh-it, me theks të veçantë për thellimin e këtij bashkëpunimi për sektorin publik dhe privat. Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka falënderuar bordin e drejtorëve të BERZh-it për zhvillimin e një vizite të tillë, e cila, sipas tij, ka mundësuar diskutimin strategjik për bashkëpunimin e Kosovës me këtë bankë. "BERZh-i mbetet partner strategjik i Kosovës, drejt adresimit të nevojave për investime në sektorin publik dhe për fuqizim të mëtutjeshëm të sektorit privat si bartës i zhvillimit ekonomik", ka thënë Hamza.

Ndërsa drejtorët e bordit të BERZh-it kanë konfirmuar gatishmërinë e këtij institucioni ndërkombëtar që ta vazhdojë përkrahjen e ekonomisë së Kosovës dhe të punës së qeverisë për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Delegacioni i bordit i drejtorëve të BERZh-it është duke qëndruar në Kosovë për vizitë dyditore si pjesë e vizitave të rregullta të cilat ky bord i realizon çdo pesë vjet në shtetet ku operon kjo bankë.

Lekaj: Bashkë me autostradën e Dukagjinit sanohet edhe shtrati i lumit Drini i Bardhë

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të hënën ka marrë pjesë në debatin publik me qytetarët e Rahovecit për autostradën e Dukagjinit. Ministri Lekaj u ka premtuar qytetarëve të Rahovecit se sugjerimet e tyre do të merren parasysh dhe se ato që janë të arsyeshme do të inkorporohen në projektin final.

I pari i Infrastrukturës dhe Transportit u tha qytetarëve se ky projekt është i qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës dhe, si i tillë, ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e vendit me korridoret pan-evropiane. Ai, pos të tjerash, u ka premtuar qytetarëve se, krahas këtij projekti, do të rregullohet edhe shtrati i Drinit të Bardhë dhe maksimalisht do të kursehet toka bujqësore, e që për rahovecianët ka rëndësi shumë të madhe.

Ndërsa qytetarët, duke vënë në pah rëndësinë e këtij projekti të munguar nga qeverisjet e kaluara, me anë të sugjerimeve të tyre kanë dhënë kontributin e tyre për projektin e autostradës së Dukagjinit.

AAK-ja ndërpret koalicionin me AKR-në në Mitrovicë

Mitrovicë, 4 shkurt (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka vendosur që të ndërpritet koalicioni me Aleancën Kosova e Re (AKR) në Komunën e Mitrovicës. "Pas tentimeve të shumta për t'i harmonizuar qëndrimet dhe programin e AAK-së në këtë komunë, është vlerësuar se AKR-ja ka mungesë të theksuar të vullnetit për bashkëpunim. Zhvillimet në javët e fundit në Mitrovicë kanë qenë vendimtare për marrjen e këtij vendimi. AAK-ja mbetet e përkushtuar për qeverisje të mirë si në nivel qendror, po ashtu edhe në atë lokal", ka njoftuar AAK-ja.

Begaj merr mbështetje nga OSBE-ja

Malishevë, 4 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të hënën në një takim pune drejtorin e Zyrës së misionit të OSBE-së për regjionin e Prizrenit, George Katcherava, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet dy institucioneve. Begaj e ka vlerësuar lart bashkëpunimin në mes të Komunës së Malishevës dhe OSBE-së. Ai ka falënderuar OSBE-në për këtë bashkëpunim, sidomos për monitorimin e punës së Komunës së Malishevës.

Ndërsa drejtori i Zyrës Regjionale të misionit të OSBE-së, George Katcherava, e ka njoftuar kryetarin Begaj me prioritetet e këtij misioni për vitin 2019, siç janë: rinia, barazia gjinore etj. dhe e ka ofruar asistencën e OSBE-së brenda misionit të vet për çështjet ku kanë kompetencë.

Demokraci Plus: Asnjë komunë nuk i ka përmbushur premtimet elektorale

Prishtinë, 4 shkurt (ER) - Organizata Demokraci Plus ka prezantuar raportin për të gjeturat dhe vlerësimin e respektimit të zotimeve nga kandidatët për kryetarë të komunave. Sipas këtij raporti, për përmbushjen e zotimeve kryeson Komuna e Prishtinës, e Prizrenit, e Pejës dhe e Gjakovës. Në nivelin më të ulët të përmbushjes së zotimeve është Komuna e Gjilanit.

Autorja e këtij raporti, Roberta Osmani, ka bërë me dije se asnjë nga komunat nuk i kanë përmbushur zotimet elektorale. Ndërsa Jemir Bakija nga Demokraci Plus ka theksuar se zotimet janë marrë nga kandidatët e shtatë komunave në Kosovë. "Kemi biseduar me kandidatët që kanë qenë për kryetarë të komunave dhe këto zotime janë marrë vetëm nga kandidatët e shtatë komunave", ka thënë Bakija.

Ndërsa nënkryetari i Prishtinës, Muhedin Nushi, ka thënë se kjo komunë mbetet në shërbim të qytetarëve, sidomos kur ankesat dhe kërkesat e tyre adresohen përmes platformës "online". Duke iu referuar raportit të Demokraci Plus, Komuna e Prizrenit prin në vendimet e kryetarit, ajo e Prishtinës për planet urbanistike dhe rregulloret komunale, Ferizaj për raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve.

Për adresimin e ankesave "online" kryeson kryeqyteti.

Haliti thotë se do të merren masa ligjore ndaj kompanive që nuk e kanë respektuar kontratën

Viti, 4 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt me drejtorët e drejtorive komunale. Gjatë kësaj mbledhje është bërë me dije se Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural tani e tutje do ta udhëheqë Arlinda Sahiti. Po në këtë mbledhje kryetari Haliti dhe drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Ibrahim Rama, kanë potencuar se institucionet komunale të Vitisë kanë analizuar projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2018. Me këtë rast, Haliti ka thënë se Komuna e Vitisë pas kësaj analize ka parë që disa projekte nuk janë realizuar sipas kontratave të cilat kanë nënshkruar disa operatorë ekonomikë.

Ai ka kërkuar që projektet të cilat nuk janë në cilësinë e paraparë me kontratë të mos pranohen. "Ne kemi bërë një analizë të cilësisë për projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit të shkuar. Kemi parë që disa projekte nuk janë realizuar sipas cilësisë që është paraparë me kontratën të cilat i kanë nënshkruar operatorët ekonomikë. Kërkoj që projektet të cilat nuk janë bërë sipas cilësisë së paraparë të mos pranohen. Nëse ato nuk rregullohen siç është paraparë me kontratat të cilat i kanë nënshkruar vetë operatorët ekonomikë duhet të marrim masat ligjore ndaj atyre që janë përgjegjës për këtë", ka thënë Haliti.

Patriotët e leshit dhe kurvat politike të Kurveleshit!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Po ku je, Adem Demaçi: Adem Demaçi, siç e quajnë patriotët e leshit dhe kurvat politike të Kurveleshit, bëri më shumë se 28 vjet burg në llogoret e ish-Jugosllavisë së kriminelëve Tito dhe Millosheviq në kohën kur shumë të tillë që i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë, sot, në Kosovën e martirizuar, janë bartës të posteve të larta politike dhe të cilët nuk i kanë merituar me asgjë, përveç me shërbimin qençe ndaj atyre që kanë keqtrajtuar, arrestuar, dënuar dhe vrarë shqiptarë! Këta maskarenj dhe injorantë e gëzojnë përkrahjen 100 % të ish-patriotëve dhe ish-shokëve të Bacës Adem Demaçi siç e quajmë ne, që të zhveshur nga patriotizmi, së paku e kemi ruajtur një respekt për Bacën e Madh që na frymëzoi të zhargitemi rrugës së rëndë drejt lirisë, çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Baca Adem, sa ishim në burgjet e ish-Jugosllavisë, dikur si atdhedashës, tash të shndërruar në karrieristë të paskrupullt, na mësoi dhe na bindi se burgu nuk është vuajtje, por se është detyrë njerëzore, kombëtare dhe morale prandaj, të gjithë që e pranuam këtë filozofi, e kaluam burgun shumë lehtë, përkundër torturave që ndaj nesh ushtronin paraardhësit biologjikë të disa këshilltarëve të Hashim Thaçit, Ramushit dhe Kadrisë. Baca na mësonte se në rrugën drejt lirisë nuk ka pengesa të pakapërcyeshme dhe se asnjë vështirësi nuk ia vlen të përmendet përballë asaj që na takon ta bëjmë. Kështu, burgun e kaluam bukur lehtë dhe, te së paku 90% e ish të burgosurve politikë nuk kishte asnjë mëdyshje se si duhet të veprohet pasi të dalim nga një burg i vogël, në një burg të madh siç ishte Kosova. Këtë Baca Adem e pati thënë në shumë raste, gjatë intervistave dhe takimeve të ndryshme. Shokët që e respektuan Bacën Adem nuk dështuan kurrë dhe nuk kishin si të dështonin sepse kishin kaluar nëpër një Akademi Jetësore Praktike, përvojat e së cilës nuk mund t'i ofronin të gjitha akademitë botërore. Nuk mund të dështonin kurrë dhe asnjëherë: Rexhep Mala, Remzi Ademaj, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Xhavit Haziri dhe Hafir Shala, Shaban Shala, Tahir Hani dhe Skender Kastrati, Zahir Pajaziti, Shashivar Makolli dhe Bajrush Behrami dhe qindra dhe mijëra heronj dhe martirë të Kosovës që, pushtetin moral dhe kombëtar nuk e ndërronin me asnjë pushtet fizik dhe material për të cilën u bënë copë e grimë alamet luftëtarë dhe komandantë të luftës së fundit, disa edhe vetë ish të burgosur politikë! Baca Adem Demaçi asnjëherë nuk e deshi pushtetin, prandaj nuk e sfidoi Rugovën duke na këshilluar të votojmë për të në zgjedhjet e para përkundër faktit që ish të burgosurit politikë, në atë kohë ishin në kulmin e popullaritetit dhe, po të donte Baca Adem, skena politike do të përçahej shumë keq, aq më parë që në radhët e LDK-së, përkatësisht në majat e saj, kishte shumë torturues të shqiptarëve liridashës, zyrtarë të lartë komunistë të Jugosllavisë dhe Serbisë, udbash dhe hetues policorë, prokurorë dhe gjyqtarë që e kishin dënuar edhe vetë Bacën Adem si dhe të atillë që kishin vrarë patriotë shqiptarë, në Kosovë dhe diasporë. Ata në fillim ishin bërthama e LDK-së e pastaj, ose ata vetë, ose bijtë dhe bijat e tyre, u sistemuan si më së miri të ish-liderët e UÇK-së, të konvertuar në politikanë dhe bartës të posteve të larta.

Dashuria dhe respekti nga një distancë e sigurt: Bacën Adem kurrë nuk e trajtuan në përputhje me sakrificën dhe kontributin kombëtar, përkundrazi, është personaliteti që më së shumti u keqtrajtua pikërisht nga ata që kanë pasur detyrim ta përkrahin dhe mbështesin. Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, e përbërë kryesisht nga komunistët sllavë të LDK-së dhe disa analfabetë të krahut të luftës, kurrë nuk u gjet një vend për Bacën Adem Demaçin përveçse organizuan fushata të ndyra kundër Bacës. Në asnjë legjislaturë të Kuvendit të Kosovës kurrë nuk u lejua që Baca Adem ta ketë një pozitë, qoftë edhe nderi, e lëre më të jetë deputet, ndonëse aty kishte deputetë që tërë kohën, vetë dhe me kotillën e tyre, kishin punuar kundër shqiptarëve dhe në dobi të serbëve, rusëve, grekëve dhe "miqve" të mëdhenj të shqiptarëve. Nuk ka mbetur kush pa folur dhe pa përrallisur para deputetëve të Kuvendit të Kosovës duke iu organizuar edhe seanca solemne por, asnjëherë nuk i ishte mundësuar Bacës Adem t'iu drejtohet të "zgjedhurve" të popullit dhe qytetarëve të Kosovës. Asnjëherë, merreni me mend! Kur, me një propozim të Bleron Baraliut, Baca Adem pranoi të hyjë në garë për president të Kosovës për ta sfiduar patriotin e madh të Kazakistanit, Gjet Pacollin, ata që pritej ta përkrahnin më së shumti, edhe e penguan me çdo mjet dhe me çdo kusht mundësinë që Baca të bëhej president i Kosovës, jo pse vdiste për këtë post, por se nuk donte të fuqizohej ndikimi i Rusisë dhe Serbisë në Kosovë përmes bajpasit Kazakistan; Albini e kushtëzoi përkrahjen për Bacën me zotimin e Bacës se do ta rrëzonte nga pushteti Hashim Thaçin, mbase për të ardhur vetë në pushtet e që Baca nuk pranoi kushtëzimin, kurse Hashim Thaçi-Pehlivani, siç e quante Baci, e angazhoi krejt Zonën Operative të Drenicës, ambasadorin Dell dhe rrugaçin Pushikar, në përkrahje të patriotit të Kazakistanit dhe në kundërshtim të Bacës Adem. Në atë kohë PDK, si parti e krahut të luftës, e luajti një rol prej kurve politike duke u rreshtuar në anën e Pacollit. Në mos e tëra, atëherë pjesa më e madhe e saj. Dhe, me tërë këtë përkrahje, Pacolli jo që do të bëhej president i Kosovës, por do të bëhej edhe president i Amerikës. Përndjekja ndaj Bacës ka vazhduar me intensitet të luhatshëm, varësisht nga situata politike. Por, gjithmonë kundër Bacës, në ndërkohë që thirreshin në emër të Bacës! Realisht u krijua një përshtypje se me Bacën Adem po manipulon krahu i luftës e që nuk ishte fare e vërtetë; nuk ka pasur bir nëne apo politikë që ka mundur ta manipulojë Bacën Adem por Baca, për interes kombëtar dhe shtetëror, ka qenë në gjendje të bëjë çdo gjë që është kërkuar nga ndërgjegjja dhe vetëdija e tij e lartë njerëzore dhe kombëtare. Baca Adem ka dhënë prova që nuk i kishte dhënë asnjë lider apo lideruc shqiptar dhe kosovar. Po i përmendi vetëm disa:

1. E pranoi udhëheqjen politike për UÇK-në në kohën kur asnjëri nuk kishte guxim të bënte këtë;
2. Nuk pranoi të shkonte në Rambuje për të "biseduar" për 8 pikat e panegociueshme ku garantohej autonomia substanciale, asgjë më shumë;
3. Dha dorëheqje nga Përfaqësuesi Politik i UÇK-së sepse, sipas Bacës, nuk donte të bëhej "shef i pisarnicës" të disa injorantëve që nuk merrnin vesh në politikë, ndërsa kishin pretendime se ishin më të zotët se vet Winston Churchilli;
4. Nuk e pranoi ofertën mashtruese të Bernard Kushnerit për pajtim të pakushtëzuar me Serbinë sepse parashtroi kushte krejtësisht normale dhe, të cilat, Kushneri tha se nuk janë të pranueshme për Serbinë;
5. Ia bëri 8 me 2 Vuk Drashkoviqit në Beograd duke ia thënë fjalët që disa trimosha të sotëm nuk kanë pasur guxim t'ia thonë as vetvetes;
6. U angazhua për të drejtat e pakicave në Kosovë kur ato ishin të rrezikuara duke kaluar në anën e tyre në kohën kur disa që bartnin apo kanë poste politike e akuzonin se do ta kolonizojë Kosovën me serbë;
7. E pushkatuan për Rambujenë, Olbrajti, Surroi, Kadareja, krejt LDK-ja dhe një pjesë karrieriste e krahut të luftës, skajshmërisht të kriminalizuar dhe të korruptuar;
8. E pushkatuan në Beograd kur nuk e ndante mendjen me Gelbartin, Rugovën dhe Holbrukun, se UÇK-ja është organizatë terroriste dhe jo ushtri çlirimtare;
9. Dha dorëheqje të menjëhershme nga kryetari i Bordit të RTK-së kur një politikan i shthurur kombëtarisht dhe moralisht ia censuroi fjalën në një manifestim.

Për mua mbeti emblematik dhe këso personalitete, së bashku me Adem Jasharin, lindin një herë në një mijë (1 000) vjet. Ndërkaq hashima, behxheta, begjeta, isa dhe pisa, lindin për çdo ditë. Më mirë do të ishte të mos lindnin fare!

Turpi i të jetuarit dhe krenaria e përjetësisë: Si çdo qenie e krijuar nga Zoti e që vjen në këtë botë me një mision të caktuar, edhe Bacës Adem i qe shkruar ta çojë deri në fund sakrificën për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, duke u flijuar deri në vetëmohim me të cilin, shumë vetë pameritueshëm kanë përfituar dhe e kanë sulmuar. Në mesin e vdekatarëve të rëndomtë vlerësohet jetëgjatësia fizike dhe mënyra e të jetuarit që nënkupton një grykësi të pashembullt. Këta janë frikacakë që nuk kanë as një të sotme e lëre më një të ardhme. Këta bëhen numër në statistikat e përgjithshme kur duhet të çregjistrohen nga lista e përfituesve të pensionit. Këta nuk i përmend askush pasi të shkojnë nga kjo botë! Këta janë shumica në botë dhe në Kosovë. Janë shumica absolute. Janë kufoma të gjalla të mbështjella me qefinët e markave më të njohura që lakmojnë shkëlqimin e kamerave, gostitë ku rrasen së ngrëni, shfrytëzimin e gjendjes së njerëzve në nevojë! Këta janë patriotët e leshit, të shoqëruar me kurva të Kurveleshit! Të gjitha këto i bëjnë nën petkun e patriotit, çlirimtarit dhe kalamarit! Këtyre nuk iu intereson përmbajtja, sepse nuk e kanë, por u intereson dukja! Ose, siç thoshte gjeniu Lasgush Poradeci, nga plehrat dalin plehra! Ndërkaq, kalorësit e përjetshëm të lirisë, asnjëherë nuk ndalen, as në këtë botë e as në tjetrën. I tillë ishte dhe mbeti Bacë Adem Demaçi, Adem Jashari dhe të gjithë ata që e dhanë jetën për liri apo, edhe kur u fitua liria, e ruajtën fytyrën, jo si pamje, por si vlerë. Këta janë ata që e fituan përjetësinë dhe jo që dikush ua ndau përjetësinë. Nuk ka asnjë dilemë midis asaj të qenit pjesë e përjetësisë dhe asaj të qenit kufomë e gjallë. Dikush këtë po e kupton ndryshe. U qoftë për hair përcaktimi!

Parkingjet e Shpendit dhe siguria e qytetarëve: Shpend Ahmeti, gjatë fushatës elektorale, në mesin e shumë premtimeve, dy prej tyre i kishte të forta: sigurinë e qytetarëve dhe sigurimin e parkingjeve, mbitokësore dhe nëntokësore. Të parin e përmbushi plotësisht, kurse të dytin vetëm pjesërisht. Për sigurinë e qytetarëve siguroi një armatë qensh duke u nisur nga parimi se qeni është miku më besnik ndaj njeriut. Tash, sidomos në Prishtinë, një qen i regjistruar me numër në vesh, e që identifikohet si qeni i Shpendit, kujdeset për sigurinë e qytetarëve të kryeqytetit, përkatësisht për çdo kokë banori në Prishtinë, përjashtuar këtu ardhacakët apo turistët njëditorë keni siguri në proporcion; një qen i Shpendit, për 8 banorë të kryeqytetit! Këtë siguri nuk e keni as në Uashington, Vjen, Berlin, Londër apo gjetiu. Sa iu përket parkingjeve, ndërtimi i parkingut nëntokësor te filozofiku apo Katedralja e Himë Govës duhet të përshpejtohet për faktin se Kisha Katolike ka hapur një qendër tregtare në kuadër të aktiviteteve shpirtërore, prandaj ka nevojë për rritje të kapaciteteve; më pak për besimtarë (janë numër simbolikë) dhe më shumë për konsumatorë (numri i tyre po rritet). Deri atëherë mund ta shfrytëzoni, pa pagesë, parkingun alternativ te Varrezat e Dëshmorëve, përkatësisht mund t'i parkoni veturat, kombibusët, kamionët apo qerret te varri i Bacës Adem Demaçi, Heroit të Kosovës dhe Nderit të Kombit. Turpi raftë mbi të gjithë juve! Por edhe mbi neve, shokëve të sinqertë të Bacës Adem! Shiheni edhe varrin e gjeneral Shaban Shalës; për më shumë se shtatë (7) vjet, vetëm një dërrasë me emrin e tij. Marre e madhe, jo për pushtetin, po për shokët e Shaban Shalës ku edhe unë bëj pjesë!

Kuvendi i Kosovës dhe diberët e Jakovës: Në seancën e fundit të Kuvendit të Kosovës bëhej një luftë gladiatorësh, kush do të rruajë mjete më shumë për partinë, lagjen, fshatin, kushëririn apo votuesit potencialë. Në mungesë të Behgjet Pacollit, vetëm një prej tyre reflektoi si duhej dhe rrezatonte nga sinqeriteti dhe ndershmëria; luftëtari i orëve të para të UÇK-së, intelektuali i madh i përmasave kombëtare, komandant "Kamishi" apo, që më pak e njohin me emër dhe mbiemër, Bekim Haxhiu.

I njohur si luftëtar i shquar i luftës çlirimtare për çka edhe u bë komandant "Kamishi", gjatë luftës dhe intelektual i shquar që po kontribuon për ndërtimin e paqes për ngritjen e brezave të rinj si ligjërues ekselent në Fakultetin e Mjekësisë, me tituj akademikë dhe shkencorë e ka edhe një shpirt sportisti sipas parimit, në trupin e shëndoshë, mendja e shëndoshë. Këtë e dëshmoi edhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit, kur pamëshirshëm dhunohej buxheti i Kosovës. Ai, në mbrojtje të sportit, propozoi që në qendër të Prishtinës të ngrihet shtatorja e Fadil Avdullah Vokrrit, ish-futbollistit të shquar dhe lobistit për pranimin e Federatës së Futbollit të Kosovës në FIFA. Në kërkesën e tij ishte shumë modest, duke kërkuar një shumë simbolike prej 200 000 eurosh e që u pranua nga Kuvendi i Kosovës. Prishtinës i duhet edhe Fadil Vokrri sepse ka kontribuar më shumë për Kosovën sesa përmendorja para Kuvendit. I duhen edhe disa përmendore si ajo e Aganit, Rrahman Morinës dhe Azem Vllasit, madje për së gjalli. Prishtina nuk ka nevojë për përmendore të Bacës Adem Demaçi dhe komandantit legjendar, Adem Jashari. Marre ju qoftë, jo krahut të luftës, prej të cilëve as që kam pritur të dalin me një propozim të tillë. Ndërgjegjja është në pyetje, vëlla. Më ka befasuar shumë keq Ismet Beqiri sepse kam pritur se ai do të flasë në emër të heronjve të kombit dhe vlerave kombëtare. Për shkak të së kaluarës së tij, e sidomos së tashmes! Bravo Bekim Haxhiu, "Kamish", se mbi këto llullat qyqare dëshmove patriotizëm dhe intelektualizëm. Moti ka përfunduar lufta. Jeta e ëmbël është. Më e mirë se kujtimet e hidhura.

JU, HORRA TË HORRASANIT DHE PATRIOTË TË KAZAKISTANIT!

Lavrovi: Nuk bëhet fjalë për një luftë të re të ftohtë

Moskë, 4 shkurt - Tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme nuk e paralajmëron fillimin e një Lufte të re të Ftohtë, por "është e turpshme", tha ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov. "Nuk mendoj se bëhet fjalë për një Luftë të re të Ftohtë. Por, një epokë e re ka nisur. Është karakteristikë e epokës së re, në të cilën ShBA-ja po thyen sistemin ndërkombëtar të kontrollit të armëve dhe sistemin që i frenon armët strategjike sulmuese. Është turp", tha Lavrovi në një vizitë në Bishkek.

Ai tha se Rusia do të përdorë mjete ushtarake dhe teknike për t'iu përgjigjur kërcënimeve që paraqet tërheqja e ShBA-së nga traktati.

Të premten sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara do t'i pezullojnë obligimet e tyre me Traktatin për Forca Bërthamore me Rreze të Mesme, nisur nga 2 shkurti.

Një ditë më vonë, edhe Rusia ka thënë se tërhiqet nga kjo marrëveshje. Uashingtoni e ka akuzuar Rusinë për shkeljen e saj me krijimin e raketës 9M729. Moska e mohon se raketa në fjalë është në kundërshtim me marrëveshjen.

Traktati ShBA - Rusi, i cili daton nga Lufta e Ftohtë dhe ka eliminuar një klasë të tërë të raketave nga Evropa, konsiderohet kyç për stabilitetin strategjik në mes të Uashingtonit dhe Moskës.

Maduro nuk e përjashton mundësinë për luftë civile në Venezuelë

Presidenti i sfiduar i Venezuelës, Nicolas Maduro, ka thënë se ai nuk mund ta përjashtojë mundësinë e luftës civile dhe ka paralajmëruar presidentin amerikan, Donald Trump, se mund të largohet "me njolla gjaku" nga Shtëpia e Bardhë, nëse intervenon në krizë

Karakas, 4 shkurt - Presidenti i sfiduar i Venezuelës, Nicolas Maduro, ka thënë se ai nuk mund të përjashtojë mundësinë e luftës civile, teksa është duke u rritur presioni ndaj tij për t'u larguar nga pushteti. Në një intervistë televizive ai ka paralajmëruar presidentin amerikan, Donald Trump, se mund të largohet "me njolla gjaku" nga Shtëpia e Bardhë, nëse intervenon në krizë. Ai ka kundërshtuar të thërrasë zgjedhje të parakohshme, pavarësisht pse të dielën Bashkimi Evropian e ka paraqitur si datë të fundit për ta bërë një gjë të tillë. Prandaj këto shtete kanë bërë me dije të hënën se njohin zyrtarisht udhëheqësin e opozitës, Juan Guaido, si president të përkohshëm të Venezuelës.

Guaido ka thënë të dielën se do të krijojë një koalicion ndërkombëtar për të ofruar ndihmë humanitare për popullin e Venezuelës, mirëpo Maduro e ka akuzuar atë për organizim të puçit.

Gjatë intervistës së tij për program televiziv spanjoll, "Salvados", Maduro është pyetur nëse kriza në Venezuelë mund të rezultojë me luftë civile. "Sot askush nuk mund të përgjigjet në këtë pyetje me siguri. Ne kërkojmë që askush të mos ndërhyjë në çështjet e brendshme dhe jemi të përgatitur për ta mbrojtur shtetin tonë," ka thënë ai.

Ndërkohë presidenti amerikan i ka thënë transmetuesit amerikan, CBS, se përdorimi i forcës ushtarake "është mundësi" që mund të realizohet në Venezuelë.

Maduro, në anën tjetër, ka paralajmëruar ShBA-në se ai rrezikon përsëritjen e Luftës së Vietnamit, në rast se intervenon. "Ndaluni! Ndaluni Donald Trump! Jeni duke bërë gabime që do të lënë duart e përgjakura dhe do të largoheni nga presidenca me njollë të gjakut. Le të respektojmë njëri-tjetrin, apo kërkoni të përsërisni Vietnamin në Amerikën Latine?", pyet ai.

Të hënën ministri i Jashtëm francez Jean-Yves Le Drian ka thënë se Guaido ka "legjitimitet për t'i organizuar zgjedhjet presidenciale". "Njerëzit janë në rrugë, njerëzit duan ndryshim", ka thënë ai për transmetuesin France Inter.

Maduro në anën tjetër është përgjigjur ashpër ndaj këtij ultimatumi. "Ne nuk pranojmë afate nga askush. Është sikur t'i kërkoj unë Bashkimit Evropian që brenda shtatë ditëve ta njohë Republikën e Katalonjës dhe, nëse nuk ndodh diçka e tillë, ne do të marrin masa", tha ai.

Mijëra persona kanë protestuar në kryeqytetin e Venezuelës, Karakas të shtunën, disa në mbështetje të Maduros, të tjerët kanë përkrahur Guaidon.

Maduro vazhdon të ketë përkrahje nga ushtria, mirëpo edhe Guaido ka fituar fuqi meqë gjenerali ushtarak, Francisco Yanez, është kthyer në zyrtarin më të lartë ushtarak që ka treguar mbështetje për të. Guaido ka thënë se ka mbajtur takime private me ushtrinë për ta fituar përkrahjen që ka presidenti i sfiduar Maduro. Ai ka thënë të ketë tentuar ta bëjë të njëjtën gjë edhe me autoritetet kineze, shtet i cili konsiderohet mbështetës tejet i rëndësishëm i Maduros.

Venezuela është përballur me krizë ekonomike për vite të tëra për shkak të inflacionit të lartë dhe mungesave themelore për ushqim dhe ilaçe. Kjo gjendje ka rezultuar me shpërngulje të mijëra personave nga ky shtet. Maduro është betuar për mandatin e dytë, ndonëse procesi zgjedhor është bojkotuar nga liderët opozitarë.

Merkeli bën thirrje për kreativitet në bisedimet për Brexit



Tokio, 4 shkurt - Kancelarja gjermane Angela Merkel i bëri thirrje Britanisë dhe Bashkimit Evropian të tregojnë kreativitet dhe vullnet të mirë në bisedimet e ardhshme për Brexit, apo daljen e Britanisë nga BE-ja. "Ne duam të bëjmë gjithçka për ta shmangur Brexitin pa marrëveshje, sepse një gjë e tillë do t'i rriste pasiguritë", tha Merkeli në një konferencë të përbashkët për media me homologun e Japonisë, Shinzo Abe, në Tokio.

Merkeli tha se marrëveshja e divorcit midis Britanisë dhe BE-së është diskutuar me përpikëri dhe se ajo nuk do të rihapet. Megjithatë, ajo tha se mospajtimet si ato rreth kufirit me Irlandën e Veriut mund të diskutohen në një të ashtuquajtur marrëveshje politike që do ta shoqëronte marrëveshjen për Brexit.

Ligjvënësit britanikë, në janar, e kanë kundërshtuar marrëveshjen që ka arritur kryeministrja britanike Theresa May me Bashkimin Evropian. Mospajtimi kryesor ka të bëjë me kufirin midis Republikës së Irlandës, e cila është anëtare e BE-së, dhe Irlandës Veriore, e cila është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar.

Mbështetësit e Brexitit thonë se me marrëveshjen e kryeministres May, Britania do të mbetej ngushtë e lidhur me rregullat doganore të BE-së.

Zyrtarë të BE-së kanë thënë se marrëveshja që tashmë është arritur nuk mund të rinegociohet. Britania duhet të largohet nga Bashkimi Evropian më 29 mars të këtij viti. Vendimi pason një referendum të vitit 2016, në të cilin qytetarët britanikë kanë votuar pro Brexitit.

PËR KË BIE KAMBANA?

(Manifesti i 30 intelektualëve evropianë)

Agim VINCA

Letra e 30 intelektualëve evropianë, shkrimtarë, filozofë, publicistë, e publikuar këto ditë, nuk është studim, as analizë, por një apel, një manifest.
Nuk më duket e drejtë, prandaj, që të kërkohet nga ky dokument t'i radhisë një për një problemet me të cilat përballet sot Bashkimi Evropian, por edhe shoqëria evropiane në përgjithësi.
Fjala është për një tekst të shkurtër, me gjithsej 635 fjalë, i cili nuk mëton të bëjë analiza, por të lëshojë një zë për rrezikun që i kanoset Idesë së Evropës nga forcat populiste e ksenofobe që kanë vërshuar kontinentin.
Letra e 30 shkrimtarëve dhe publicistëve evropianë, në mesin e të cilëve është edhe shkrimtari ynë Ismail Kadare, është një kambanë alarmi për rrezikun që i kanoset Evropës, siç do të thoshte europianisti i madh Denis de Rougemont, nga "vala e re e shovinizmave fanatikë etnikë", në njërën anë dhe nga "materializmi primitiv", në anën tjetër.
Autori i këtij manifesti, filozofi francez Bernard-Henri Lévy, alias "BHL", i njohur botërisht si intelektual publik dhe të 29 nënshkruesit e tjerë të tij, e japin mesazhin qysh në titull: "Evropa në rrezik" (në origjinal frëngjisht: "Europe en péril")!
Në teorinë e shkrimit kjo quhet: "in medias res", që në shqip ka kuptimin: të hysh drejt në temë.
Autorët e letrës e quajnë veten pa kompleks "patriotë evropianë" dhe besojnë se të tillë ka shumë në tërë kontinentin, por edhe se ata janë të heshtur, prandaj u bëjnë thirrje të zgjohen për t'u bërë pjesë e një beteje të re për qytetërimin.
Nuk e fshehin gjithashtu as shqetësimin për zgjedhjet e radhës për Parlamentin Evropian, të cilat ka rrezik t'i fitojnë forcat që janë kundër vlerave për të cilat angazhohen ata: partitë e ekstremit të djathtë, çfarë është, fjala vjen, Fronti Nacional në Francë dhe simotrat e tij në vendet e tjera evropiane.
Ideja e Bashkimit Evropian lindi pas Luftës së Dytë Botërore si përgjigje ndaj çmendurisë totalitare të shekullit XX: nazizmit, në njërën anë dhe komunizmit stalinist, në anën tjetër, pra si përgjigje ndaj këtyre dy ideologjive totalitare, të cilave u paguan tagër të shtrenjtë popujt e Evropës dhe të mbarë botës.
Fitorja eventuale e shkatërruesve të këtyre vlerave - që janë vlerat e demokracisë liberale - në zgjedhjet e majit do të ishte dështim për të gjithë ata që besojnë në inteligjencën dhe kulturën dhe në trashëgiminë e etërve të Ëndrrës dhe Idesë së madhe Europiane.
Në letrën e 30 intelektualëve evropianë flitet edhe për braktisjen që po i bëhet Evropës së Bashkuar nga dy aleatët e mëdhenj të saj, njëri përtej La Manshit dhe tjetri përtej Atlantikut.
Dalja e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian ("Brexit"-i i shumëpërfolur) dhe kursi politik i presidentit aktual amerikan, e cenojnë jo vetëm Bashkimin Evropian si bashkim politik dhe ekonomik, por edhe kulturën dhe qytetërimin euroatlantik.
Nuk mund të anashkalohej në një tekst si ky, as roli destruktiv i Rusisë në zhvillimet e sotme në Evropë, sikundër edhe në botë. Federata Ruse dhe shefi i saj autokrat, nuk lënë gur pa luajtur për ta dëmtuar "rivalin" e vet evropian.
Tre çerek shekulli pas disfatës së fashizmit dhe tridhjetë vjet pas rënies së Murit të Berlinit, Evropa si ide, si vullnet dhe si strukturë ka rrezik të shpërbëhet para syve tanë.
Rënia e saj do të ishte humbje e madhe jo vetëm për vendet që janë pjesë e Unionit, por edhe për të gjithë popujt që aspirojnë të bëhen pjesë e tij, përfshirë edhe shqiptarët.
Bashkimi Evropian ka edhe gabimet e veta, thonë autorët e letrës. Le të na lejohet t'i nënvizojmë, a propos, dy sosh që nuk përmenden në tekstin e saj: qëndrimi burokratik i Brukselit ndaj vendeve që presin me dekada t'u hapen dyert e BE-së dhe paragjykimet e vjetra e të reja për popujt e "periferisë" së kontinentit, ku ne shqiptarët, mjerisht, jemi ndër të parët.
Nobelisti turk Orhan Pamuk, në deklaratën e tij pas publikimit të letrës, tha: "Pa idenë e Evropës është vështirë të mbrohen liria, të drejtat e njeriut, demokracia, barazia në pjesën time të botës", duke shtuar se këto vlera nuk mund të imagjinohen "pa suksesin historik të Evropës" .
Pjesa e botës në të cilën jetojmë ne nuk është e largët në asnjë pikëpamje nga ajo e Pamukut.
Evropa na e bën më të lehtë mbrojtjen e këtyre vlerave, që janë qenësore për njerëzimin, sepse për ne ajo është jo vetëm paradigmë e lirisë, por edhe shpresë për të ardhmen.
Ja përse duhen dëgjuar dhe, pse jo, edhe mbështetur zërat që alarmojnë rrezikun që i kanoset Idesë sublime të Evropës dhe vlerave qytetëruese që përfaqëson ajo.
Detyrë e intelektualëve është ta paralajmërojnë të keqen dhe t'i kundërvihen asaj me mjetet që kanë në dispozicion: fjalën dhe mendjen.
Edhe i madhi Tomas Man në vitin 1934 kërkonte nga intelektualët evropianë t'i kundërviheshin marrëzisë së re të njerëzimit: përshkallëzimit të fashizmit.
Nuk e dëgjuan sa duhet, prandaj edhe ndodhi ajo që ndodhi: katastrofa që mori jetën e miliona njerëzve dhe shkatërroi edhe vetë Gjermaninë.
Manifesti i 30 intelektualëve evropianë, shkrimtarë, publicistë e të tjerë, secili më i madh se tjetri, është një kambanë alarmi.
Për kë bie kambana?
Kambana bie për ata që kanë vesh!

E rrallë

I dënuari në arrati jep me qira shtëpinë luksoze

Një i arratisur britanik, i cili i shmangu dhjetë vjet burg, duke ikur në Dubai, ka dhënë me qira shtëpinë e vet luksoze. Zahid Khan, 31 vjeç, u arratis nga shtëpia në Birmingham, pasi u dënua për mashtrim. Rezidenca prej 700 mijë sterlinash, në Yardley Wood Road, ka gjashtë dhoma gjumi, tri banja, një pishinë me ujë të ngrohtë dhe kinema. Ajo, gjithashtu, ka një xhakuzi dhe dhoma me avull.

FOTO E DITES

Njerëzit kalojnë afër një peme të mbuluar me akull në Ontario të Kanadasë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Granata e Luftës së Parë Botërore gjendet në ngarkesën me patate

Një granatë dore gjermane e Luftës së Parë Botërore është gjetur në një ngarkesë me patate të transportuara nga Franca në një fabrikë në Hong Kong. Pajisja shpërthyese, e cila ishte tetë centimetra e gjerë, ishte "në një gjendje të paqëndrueshme" për shkak se i ishte hequr siguresa, por nuk kishte arritur të shpërthente. Ajo u zbulua në fabrikën e përpunimit të çajit Calbee në rrethin lindor Sai Kung, mëngjesin e së shtunës.

BARSOLETA E DITËS

Diku në Drenicë:
Burri: - Oj gru, djali u rrëzu në sallon! E paska thy krahun!
Gruaja: - Të thosha, o njeri, mos e shtro sallonin me asfalt!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Jeni duke punuar për të ardhmen tuaj dhe po e mendoni mjaft seriozisht mundësinë për të lëvizur diku tjetër.

DEMI
Në ambientin e punës duhet të krijoni kushte optimale për veten tuaj dhe për harmoninë midis kolegëve. Mos i vini re gjërat e vogla dhe pa rëndësi.

BINJAKËT
Keni kaluar limitet me një person që ka besuar te ju. Nëse sot doni t'i rregulloni raportet, pala tjetër nuk ka aspak të njëjtin mendim.

GAFORRJA
Sot nuk keni pse tregoheni sipërfaqësor me problemet tuaja. Duhet të shihni në detaje shenjat që ju jepen për të kuptuar se ku keni gabuar.

LUANI
Sot jeni shumë të zënë me punë dhe për këtë arsye do të lini pas dore njerëzit tuaj të dashur. Momentet e humbura nuk ju kthehen më pas.

VIRGJËRESHA
Edhe pse nga të tjerët kërkoni shumë përkushtim kundrejt jush, ju vetë nuk jeni i gatshëm ta bëni këtë gjë për personat e afërt.

PESHORJA
Po kuptoni që personat që qëndrojnë pranë jush kanë interesa të tjera sesa miqësi reale. Do të filloni të mbani distanca dhe të tregoheni arrogant.

AKREPI
Duhet të krijoni përshtypje të pavarur nga të tjerët për persona të caktuar sot. Jeni paragjykues dhe kjo gjë do t'ju prishë punë personalisht.

SHIGJETARI
Dëshira dhe pasioni që kishit për një person të caktuar është shuar. Ju desh pak kohë derisa ta kuptonit, por tashmë jeni të qartë.

BRICJAPI
Ata që ju duan nuk kërkojnë asgjë tjetër përveçse lumturinë tuaj. Duke mos e kuptuar këtë gjë do të lëndoni pa masë një mik të afërt.

UJORI
Jeni më të hapur me ata që sapo i njihni sesa me personat afër jush. Keni frikë mos kërkojnë diçka që s'mund ta realizoni.

PESHQIT
Ka persona në jetën tuaj të përditshme që po ju bezdisin dhe me të cilët e dini mjaft mirë që nuk mund të ndërmerrni asgjë të përbashkët.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	MARSEILLE - BORDEAUX	1	DORTMUND - BREMEN	1,3+	QPR - PORTSMOUTH	2

Rexha: Duhet ta eliminojmë Ferizajn, synojmë Kupën

Sulmuesi Kastriot Rexha ka paralajmëruar se skuadra e Feronikelit do ta sigurojë kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës. "Në Ferizaj do të jetë ndeshje e rëndësishme për ne pasi synojmë ta ndjekim edhe Kupën. Shpresojmë të kalojmë këtë ndeshje. Kjo është ndeshja e parë për sezonin pranveror. Nëse e nisim me sukses, mund të jetë e rëndësishme edhe për ndeshjet e radhës në kampionat", ka thënë Kastriot Rexha

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Futbollisti Kastriot Rexha është ndër pikat më të forta në këtë kampionat te skuadra e Feronikelit e cila është nënkampione vjeshtore dhe një nga favoritet kryesore në garën për titull dhe Kupë. Sulmuesi prishtinas të hënën për "Epokën e re" ka thënë se përballja e së shtunës në çerekfinale të Kupës ndaj Ferizajt është shumë e rëndësishme për "Niklin", kurse është optimist se do të arrihet kualifikimi në gjysmëfinale.

Sulmuesi Kastriot Rexha ka paralajmëruar se skuadra e Feronikelit do ta sigurojë kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës. "Në Ferizaj do të jetë ndeshje e rëndësishme për ne pasi synojmë ta ndjekim edhe Kupën. Shpresojmë të kalojmë këtë ndeshje. Kjo është ndeshja e parë për sezonin pranveror. Nëse e nisim me sukses, mund të jetë e rëndësishme edhe për ndeshjet e radhës në kampionat", ka thënë Kastriot Rexha, i cili ka folur edhe për fazën përgatitore që skuadra e drejtuar nga Zekrija Ramadani e bëri në Turqi. "Ka qenë mjaft efektive faza përgatitore në Turqi dhe jemi të kënaqur shumë me rrjedhën e deritashme të kësaj faze, pasi kemi pasur edhe ndeshje miqësore me kundërshtarë të fortë dhe kemi treguar se kemi skuadër cilësore", ka shtuar ai.

Pavarësisht prej fondit të madh të futbollistëve, drejtuesit e Feronikelit nuk qëndruan duarkryq në afatin kalimtar të janarit, pasi në Drenas sollën gjashtë futbollistë: Riza Zhdrellën, Met Millakun, Adenis Shalën, Hamed Konen, Esat Jasharin. Rexha është shprehur i kënaqur me reagimin e klubit, kurse rikthimi i Hamed Kones beson se do t'i hyjë shumë në punë skuadrës së Feronikelit pasi që ka përvojë të madhe. "Transferimet e ardhura janë për të mirën e skuadrës. Normalisht se e shtojnë konkurrencën dhe rrisin nivelin e lojës. Shpresoj të komponohen shpejt dhe besoj se do të jenë ndihmesë e madhe në rrugëtimin drejt arritjes së synimeve. Kone është lojtar me përvojë dhe besoj se do të na hyjë në punë", ka deklaruar Rexha.

Skuadra e Feronikelit në vjeshtë pati paraqitje shumë të mira dhe për shumë kohë ishte lidere e elitës, kurse nga shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara, ka arritur të regjistrojë dymbëdhjetë fitore, tri barazime dhe dy humbje.

Zbulohet orari i ndeshjeve çerekfinale të Kupës

Është caktuar orari i ndeshjeve çerekfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, të cilat do të zhvillohen këtë fundjavë dhe të cilat do ta hapin stinorin pranveror të garave. Të shtunën nga ora 13:00 zhvillohet ndeshja e parë në mes të Ferizajt dhe Feronikelit, kurse të dielën nga ora13:00 zhvillohen dy ndeshjet e tjera: Vëllaznimi - Drita, Kika - Ballkani, kurse nga ora 15:00 zhvillohet derbi në mes të Prishtinës dhe Trepçës '89.

SHKURT

Zhegrova në Basel

Ylli i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova i është bashkuar Baselit në Zvicër. Lajmi është konfirmuar nga skuadra e Genkut, e cila, përmes një postimi në faqen zyrtare, ka njoftuar për arritjen e një marrëveshje me Baselin për transferimin e Zhegrovës. "Genk ka arritur marrëveshje me klubin zviceran FC Basel për transferimin e Edon Zhegrovës. Baseli e huazon Zhegrovën për një sezon e gjysmë, me opsion për ta blerë", thuhet në njoftimin e Genkut.

Kosova me dy boksierë në Hungari

Kosova sot (e martë) do të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar të boksit në Hungari. Në këtë turnir që do të mbahet në qytetin e Debreçenit "Bocskai Istvan", Kosova do të përfaqësohet nga dy boksierë, Shpëtim Bajoku, që do të garojë në kategorinë deri në 64 kg, si dhe Ardit Deliaj në kategorinë 84 kg, njofton Federata e Boksit e Kosovës. Në delegacion do të jenë edhe selektori Shefki Bogujevci si dhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli. Turneu zgjat nga data 5 - 10 shkurt 2019, kurse pjesëmarrëse janë më shumë se 30 shtete.

Messi luan në "El Clasico"

Të mërkurën në mbrëmje do të luhet ndeshja e parë në mes të Barcelonës dhe Real Madridit për "Kupën e Mbretit", faza gjysmëfinale. Në kampin katalanas të gjithë janë me zemër të ngrirë sepse flitet se Leo Messi do të mungojë në sfidë për shkak të një dëmtimi jo të rëndë muskulor që pati në ndeshjen me Valencian. Por burime të sigurta nga brenda ekipit bëjnë me dije për gazetën katalanase "Sport", se argjentinasi do të luajë pa asnjë problem, duke qenë se po stërvitet normalisht. Nëse nuk ka dhimbje deri të mërkurën në mbrëmje lojtari do të grumbullohet dhe do të luajë si titullar në këtë "El Clasico".

Më 9 shkurt fillon stinori pranveror në hendboll

PRISHTINË, 4 SHKURT - Të shtunën, më 9 shkurt, fillon stinori pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Të shtunën dhe të dielën e ardhshme do të zhvillohen ndeshjet e javës së 15-të, ndërsa pritet një hendboll cilësor e rivalitet mes të skuadrave. Ndeshjet e javës së parë pranverore janë: Besa Famgas - Drita, Vushtrria - Kastrioti, Zhegra - Prishtina, Vëllaznimi - Samadrexha, Drenica - Trepça. Federata e Hendbollit i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e stinorit pranveror. Përveç trajnimeve për trajnerë, gjyqtarë e delegatë, është bërë edhe kontrollimi i obliguar mjekësor për lojtarët. Në Superligën e hendbollisteve stinori pranveror nis më vonë, më 2 mars.

Gjendet një trup në avionin e rrëzuar me të cilin udhëtonte Sala

CARDIFF, 4 SHKURT - Është gjetur një trup në avionin e rrëzuar në kanalin e La Manshit me të cilin udhëtonte futbollisti argjentinas Emiliano Sala dhe piloti. Lajmin e bën të ditur Departamenti i Transportit britanik, pa dhënë detaje se kujt i përkiste kufoma. Për momentin nuk është e qartë nëse trupi është i Salas apo i pilotit David Ibbotson. Në vendin e ngjarjes po bëhen të tjera verifikime, për të vijuar më pas me identifikimin e trupit. Mbetjet e avionit i pikasën në shtratin e detit nga një anije kërkuese, e pajtuar për nga familja për ta gjetur avionin, i cili humbi nga radarët mbrëmjen e 21 janarit. Horacio Sala, babai i futbollistit të humbur, Emiliano, ka thënë se ishte i dëshpëruar pas zbulimit të avionit "Piper PA-46" në thellësitë e kanalit anglez. "Unë nuk mund ta besoj. Jam i dërrmuar shpirtërisht dhe psikologjikisht. Gruaja ime, dy fëmijët e mi dhe disa miq të Emilianos, janë atje. Sot nuk kam komunikuar dot me askënd. Kam folur çdo ditë me ta, por telefoni dhe 'Whatsapp' nuk po funksionojnë në atë zonë", ka thënë Horacio.



Skitarët e Kosovës marrin pjesë në Kampionatin Botëror 'Are 2019'

Prishtinë, 4 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës në skitari ka udhëtuar për në Suedi, ku prej 4 deri më 17 shkurt 2019 në qytetin Are do të mbahet Kampionati Botëror. Kosova do të përfaqësohet me pesë garues të skijimit alpik. Përfaqësuesi i vetëm i Kosovës në Lojërat Olimpike Dimërore "PyeongChang 2018", Albin Tahiri, do të garojë në pesë disiplina: sllallom, sllallom të madh, super sllallom i madh, kombinim alpik dhe lëshim. Tahiri ka deklaruar se në Botërorin 2019 do të synojë t'i marrë rezultatet më të mira. "Pres ta bëjë më të mirën time, të kem paraqitje të kënaqshme dhe rezultatet do të vijnë eventualisht", ka thënë Tahiri për "noc-kosovo.org". Ai jeton në Suedi, kurse Kosovën e

përfaqëson prej vitit 2010 në gara të ndryshme ndërkombëtare. Katër garuesit e tjerë, Fiona Rrusta, Faton Shurrdhaj, Adea Kollqaku dhe Arbi Pupovci, do të garojnë në disiplinat: sllallom dhe sllallom të madh, mirëpo paraprakisht të katërtit duhet ta kalojnë garën parakualifikuese për të hyrë në garën finale.

Toronto merr kreun në Lindje, Bostoni 'leksion' Oklahomës

TORONTO, 4 SHKURT - Tri ndeshje janë luajtur në NBA, por emocionet dhe rezultatet surprizë nuk kanë munguar. Skuadra e Torontos mposhti 121-103 Clippersin, një përballje mes dy ekipesh pretendente në konferencat përkatëse. Ekipi kanadez dominoi gjatë gjithë kohës në ndeshje, ku u dallua Leonard me 18 pikë, ndërkohë që diferencën e bënë lojtarit e stolit, nga erdhën 59 pikë. Suksesi mban Toronton në vendin e dytë në Lindje. Fiton edhe skuadra e Bostonit që, pas një ndeshje spektakolare, triumfoi 134-129 ndaj Oklahomës, një tjetër sfidë ku u përballën dy nga ekipet më të mira në NBA. Skuadra e Celticsit pati vazhdimisht komandën e lojës, por pa u shkëputur, sfidë ku diferencën e bëri Irvingu, autor i 30 pikëve e 11 asistimeve. Për miqtë u dalluan George me 37



pikë e Westbrooku me një "triple double" (22 pikë, 22 rebounde e 16 asistime), por që mbetën për statistikë, raporton "Telesport". Skuadra e Memphisit mposhti 96-84 New Yorkun në fushën e këtij të fundit, sfidë me dy pamje, më e mirë për nju-jorkezët në pjesën e parë, por mungesa e një lideri ndikoi më tej. Ndërsa në të dytën erdhi përmbysja e Memphisit, ku u dalluan Conley me 25 pikë e Marc Gasoli me 24.

REZULTATET

New York - Memphis	84-96
Boston - Oklahoma	134-129
Toronto - Clippers	121-103

SHKURT

Vajushi prezantohet te Teuta

Teuta prezanton blerjen e bujshme të afatit kalimtar të dimrit. Tashmë, nën urdhrat e trajnerit Bledi Shkëmbi, do të jetë edhe një "xhevahir" i sprovuar brenda dhe jashtë vendit. Fjala është për Armando Vajushin, sulmuesin shkodran, që ka qenë pjesë edhe e kombëtares kuqezi. Shkodrani ka hedhur firmën mbi kontratë, duke u zyrtarizuar te "djemtë e detit" deri në fund të këtij sezoni. "Armando Vajushi ka firmosur sot paradite kontratën, që e bën zyrtarisht pjesë të Teutës. Ai është përforcimi i katërt zyrtar për skuadrën durrsake. 27-vjeçari në sezonin e fundit ka qenë pjesë e F. C. Pro Vercellit!", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Durrësi.

Aliti nga Skënderbeu transferohet te Kalmari

Qendërmbrojtësi Fidan Aliti u transferua nga Skënderbeu te Kalmar FF dhe ka nënshkruar një kontratë katërvjeçare. Ai ka përfunduar testet mjekësore në Kopenhagë dhe iu ka bashkuar pjesës tjetër të ekipit në kampin e trajnimit në Belek të Turqisë. Fidan Aliti debutoi për ekipin kombëtar shqiptar në 2014 dhe i ishte i pranishëm në dy ndeshje kombëtare para se ta merrte hapin për të përfaqësuar Kosovën në vitin 2016. Atje ka pasur gjithsej njëmbëdhjetë ndeshje. Gjashtë në Ligën e Kombeve, katër ndeshje miqësore dhe një ndeshje në kualifikimet në Kupën e Botës.

Lewandowski: Do të jetë vështirë ndaj Liverpoolit

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, e ka vlerësuar përballjen me Liverpoolin në Ligën e Kampionëve shumë të vështirë. "Në momentin që shorti na vuri përballë Liverpoolit mendimi im i parë ishte që do të kemi punë të madhe për të bërë. Në sulm ata kanë shumë lojtarë të cilët janë të shpejtë dhe shumë të mirë. Ata ndërrojnë stilin e lojës shumë shpejt nga mbrojtja në sulm dhe kjo i bën ata shumë të rrezikshëm, por kur ne të jemi gati nuk do të mund ta ndalin lojën. Në lojë të tilla duhet të tregojmë se sa të mirë jemi, por duhet të japim 110 % nga vetja jonë", ka thënë Lewandowski. Përballja e parë në mes të Liverpoolit dhe Bayern Munchenit zhvillohet më 19 shkurt në "Anfield".

Hazardi: Higuaini do të shënojë shumë gola

Gonzalo Higuain është transferuar te Chelsea në afatin kalimtar të janarit, kurse në fundjavën që e lamë pas ka shënuar edhe golat e parë për skuadrën blu nga Londra. Sulmuesi argjentinas ka marrë lëvdata nga mesfushori Eden Hazard. "Ai është, pa dyshim, një sulmues shumë i fortë. Luan më pak brenda zonës krahasuar me Zhiru, por ka një kontroll të mirë të topit dhe i pëlqen të luajë me një takim. Gonzalo është një futbollist shumë inteligjent dhe brenda zonës është i pabesueshëm. Mendoj se ai do të shënojë me të vërtetë shumë gola", ka thënë Hazardi.

Juve transferon Marcelon për 45 milionë euro

Juventusi prej kohësh ka shprehur interesin e madh që ka për të sjellë në Torino, mbrojtësin e Real Madridit, Marcelo. Braziliani duket se është lodhur në Madrid dhe do të ndryshojë ekip. Në këtë ka ndikuar edhe Ronaldo, i cili i ka folur shumë mirë për jetën në Itali dhe për skuadrën e Juventusit dhe organizimin e tyre. Sipas atyre që raportojnë mediet spanjolle dhe veçanërisht "Marca", Juventusi do të japë 45 milionë euro dhe do të bëjë pjesë tek ekipi brazilianin. Transferimi do të bëhet në verë dhe bardhezinjtë do të sakrifikojnë Aleks Sandron. Nga ana tjetër, bëhet fjalë që Juventusi me 90 milionë euro do të marrë Marcelon, por edhe James Rodrigezin.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

ZYRA E KRYEMINISTRIT ***vazhdon afatin e konkursit*** këto vende të punës:

I. ***NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM***
Dy (2) Auditor të Brendshëm
Numri i referencës: ZKM-NJAB-002; ZKM-NJAB-002
Koeficienti : 15

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Njësisë për Auditim të Brendshëm kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për bërjen e auditimeve edhe shërbimeve përkatëse;
2. Kryen/udhëheq auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
3. Përgatit draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bënë intervistën përfundimtare me të audituarin;
4. Hartون raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
5. Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësive organizative;
6. Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët në njësinë e auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
7. Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës; Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës.
8. Të vlerësoj sistemet e kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti lartë se janë adekuate;

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e auditimeve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kritere specifike për auditorin e brendshëm janë:

- Të ketë kryer me sukses trajnimin rigoroz profesional dhe testimin për auditor të brendshëm;
- Të jetë i certifikuar;
- Të zhvilloj vazhdimisht njohuritë, shkathtësitë, aftësitë profesionale për të ruajtur licencën për auditor të brendshëm dhe ruajtjen e licencimit duke marrë pjesë në trajnime në minimum 30 orë brenda vitit si dhe të ruajnë çertifikimin e tyre profesional në fusha të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm si: auditim të brendshëm, kontabilitet, financa, menaxhim në sektorin publik, teknologji informative, prokurim publik e të tjera.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional ne organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës se punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : http://kryeministri-ks.net/dokumente/; http://www.kryeministri-ks.net/zck/.

Dokumentacioni duhet të dorëzohen në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabuesshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

Vazhdohet afati i konkurrimit edhe 7 ditë kalendarike, nga data 05/02/ 2019 deri me datë 11/02/2019, deri në orën 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

KANCELARIJA PREMIJERA, ***produžava rok konkursa*** za sledeće radno mesto :

I. ***JEDINICA ZA UNUTRAŠNJU REVIZIJU***
Dva (2) Unutrašnja Revizora
Poziv na br: ZKM-NJAB-002; ZKM-NJAB-002
Koeficijent : 15

Zadaci i odgovornosti : Pod nadzorom direktora Jedinice za unutrašnju reviziju obavlja sledeće dužnosti i odgovornosti:

1. U saradnji sa nadzornim učestvuje u izradi plana revizije i usvaja planove rada i rokove za vršenje revizije i odgovarajućih usluga;
2. Obavlja/rukovodi revizije, uključujući uvodne intervjue sa sektorom gde se vrši revizija, intervjuiše osoblje, prezuzima i analizira relevantnu dokumentaciju i registruje nalaze;
3. Priprema nacrt izveštaja, diskutuje sa nadzornikom i vrši završne inturvjue sa onim nad kojim se vrši revizija;
4. Izrađuje konačni izveštaj sa odgovarajućim preporukama, finalizira dosije revizije i dostavlja ga na arhiviranje;
5. Prati sprovođenje preporuka od strane institucija i organizacionih jedinica;
6. Daje upustva osoblju nižeg nivoa u jedinici za unutrašnju reviziju za izvršenje njihovih dužnosti i odgovornosti;
7. Daje savete o pitanjima interne revizije u okviru institucije, prema potrebi; Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira sa spoljnim organima, prema potrebi.
8. Procenjuju sisteme unutrašnje revizije dizajnirane od strane višeg rukovodstva o tome da su adekvatni;

Kvalifikacije, ardno iskustvo i sposobnosti:

- Unverzitetska diploma iz oblasti ekonomije, javne uprave, javnih finansija, računovodstva ili prava;
- Najmanje tri (3) godine stručnog radnog iskustva;
- Znanje i značajno iskustvo u oblasti revizije;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i timskog rukovođenja;
- Istraživačke, analitičke i procenjivačke veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Specifični kriterijumi za unutrašnjeg revizora su:

- Da je uspešno završio rigoroznu stručnu obuku i testiranje za unutrašnjeg revizora;
- Da je sertifikovan;
- Da stalno razvija znanje, veštine, stručne sposobnosti za održavanje licence za unutršanjeg revizora i održavanje licenciranja učestvovanjem na obukama najmanje 30 časova godišnje i da održava njegovu profesionalnu sertifikaciju u različitim oblastima sistema unutrašnje kontrole kao što: unutrašnja revizija, računovodstvo, finansije, upravljanje u javnom sektoru, informatička tehnologija, javna nabavka idr.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISANJA

Kancelarija Premijera pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije od strane svih zajednica na Kosovu.

Ne-većinske zajednice imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe kao što je navedeno u članu 11. stav 3 Zakon br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju treba priložiti sledeću propratnu dokumentaciju: popunjeni obrazac za aplikaciju, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju biti nostrifikovane od strane MONT-a) , dokaz radnog iskustva, dve reference .

Zahtev za zapošljavanje i opis radnog mesta se može dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosovo (ul. Majke Tereze bb). Zvanični obrazac za aplikaciju, možete naći i na web stranici: http://kryeministri-ks.net/dokumente/; http://www.kryeministri-ks.net/zck/;

Dokumentacija treba biti dostavljena Kancelariji za ljudske resurse, zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406.

Korišćenje pogrešnog obrazca i nepotpunog sa podacima koji su potrebni, će se smatrati nevažećim.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati koji su ušli u uži spiska će biti kontaktirani.

Kandidati koji su izabrani u uži spisak će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZCS, uključujući i period probnog rada je (1) godinu dana.

Produžava se rok za konkurisa za još 7 kalendarsi dana počev od 05/02/ 2019 do 11/02/2019, do 16:00 h.

Prijave pristigle nakon poslednjeg dana za konkurisnaje neće biti prihvaćene.

Za dodatne informacije, pozovite brojeve : 038 200 14 818 i 038 200 14 817

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria
Vlada - Government

Ministria e Integrimit Evropian
Ministarstvo Evropske Integracije - Ministry of European Integration

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bën:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	**Ministria e Integrimit Evropian**
Njësia Organizative:	**Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme**
Titulli i punës:	**Zyrtar për Informim**
Numri i referencës:	**01/2019/DKI/MIE**
Niveli i pagës:	**E negociuar**
Raporton te:	**Udhëheqësi i Divizionit për Komunikim dhe Informim**
Lloji i kontratës:	**Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)**
Kohëzgjatja e kontratës:	**Gjashtë (6) muaj**
Orari i punës:	**I plotë**
Numri i ekzekutuesve:	**3 (tre)**
Vendi:	**Prishtinë**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me zyrtarin e lartë harton dhe zhvillon planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë; 15%
- Monitoron i mediat e shkruara dhe elektronike dhe përgatit një përmbledhje të informatave për menaxhementit e lartë të ministrisë; Mirëmban dhe përditëson me informata faqen zyrtare të institucioni;15%
- Pranon dhe shqyrton kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare si dhe kryen të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për qasje në dokumentet publike;10%
- Në bashkëpunim me Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave përgatit raportet 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore për zbatimin e Ligjit për qasje në Dokumente Publike;15%
- Ndihmon në përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun dhe pas miratimit të tyre nga mbikëqyrësi dhe menaxhmenti i ministrisë i shpërndan tek mediat e shkruara dhe elektronike dhe i vendos ne ueb faqen e ministrisë ; 15%
- Përgatit përgjigjet për kërkesat e pranuara nga mediat e shkruara dhe elektronike lidhur me aktivitet dhe shërbimet e ministrisë 10%
- Përcjell takimet, seminaret, konferencat e ndryshme, që organizohen nga ministria dhe njësit organizative të saj dhe përgatit informatën për këto ngjarje ; 5%
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyersi; 15%.

Shkathtësitë e kërkuara: (*Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

